


RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR
MBI
PASQYRAT FINANCIARE TË SHOQËRISË

“BOREN OIL” SHPK



PERIUDHA USHTRIMORE

01.01.2019 – 31.12.2019

Bendis Husi

BENDIS HUSI
L52222001G
Nr rregj 368 dt 08.01.2019

Z. VILSON DUSHKU!

Ortak i vetëm i shoqërisë "BOREN OIL" shpk, Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, kulla Nr.1, Kati 13, Tiranë.

I NDERUAR ZOTËRI!

OPINIONI

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "**BOREN OIL**" shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë "**BOREN OIL**" shpk me datën 31 Dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

BAZA PËR OPINIONIN

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Profesionistëve Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (kodi i BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

PËRGJEGJËSITË E DREJTIMIT NË LIDHJE ME PASQYRAT FINANCIARE

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për

Bendis Husi

BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE


Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Ne do të ushtrojmë gjykimin tonë profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit, në pajtim me SNA-të.

Ne do të identifikojmë dhe të vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, do të hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve si dhe, do të marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontrolleve të brendshme.

Ne do të sigurojmë njohjen dhe kuptimin për kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin, në mënyrë që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion lidhur me efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm të entitetit.



Bendis Husi


BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

Ne do të vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e çmuarjeve (vlerësimeve) kontabël dhe informacioneve shpjeguese përkatëse të dhëna nga drejtimi.

Ne do të arrijmë në një konkluzion lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë nga ana e drejtimit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, do të vlerësojmë nëse ekziston një pasiguri materiale lidhur me ngjarje ose rrethana të cilat mund të hedhin një dyshim të madh për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë. Konkluzionet tona do të bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana të ardhshme mund të bëjnë që entiteti të ndalojë së vijuari veprimtarinë.



TIRANË, 13 QERSHOR 2020

AUDITUES LIGJOR

Bendis Husi




BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR
PERIUDHA 05.08.2019 – 31.12.2019



"BOREN OIL" SHPK

13 QERSHOR 2020



BENDIS HUSI
AUDITUES LIGJOR

PËRMBAJTJA

I. RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

II. PASQYRAT FINANCIARE 31.12.2019

- ❖ PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)
- ❖ PASQYRA E PERFORMANCËS (PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE)
- ❖ PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE
- ❖ PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO

III. SHËNIME PËR DREJTIMIN E SHOQËRISË


- ❖ TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SHOQËRINË
- ❖ PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL
- ❖ ORGANIZIMI I KONTABILITETIT
- ❖ SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

BOREN OIL
SH. PAKETIM
KONTABILITETI
TIRANË

BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368-dt 08.01.2019



I. RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR
MBI AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË

"BOREN OIL" sh.p.k

DREJTUAR: Z. VILSON DUSHKU!

Ortak i vetëm i shoqërisë "BOREN OIL" shpk, Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla Nr.1, Kati 13, Tiranë.

Lidhur me shqyrtimin e Pasqyrave Financiare të periudhës gusht-dhjetor 2019.

I NDERUAR ZOTËRI!

OPINIONI

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "**BOREN OIL**" shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë "**BOREN OIL**" shpk me datën 31 Dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

BAZA PËR OPINIONIN

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Profesionistëve Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (kodi i BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Bendis Husi
BENDIS HUSI
L52222001G
Nr rregj 368 dt 08.01.2019

PËRGJEGJËSITË E DREJTIMIT NË LIDHJE ME PASQYRAT FINANCIARE

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritët që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Ne do të ushtrojmë gjykimin tonë profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit, në pajtim me SNA-të.

Ne do të identifikojmë dhe të vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, do të hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve si dhe, do të marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontroleve të brendshme.

BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

"BOREN OIL" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

Ne do të sigurojmë njohjen dhe kuptimin për kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin, në mënyrë që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion lidhur me efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm të entitetit.

Ne do të vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e çmuarjeve (vlerësimeve) kontabël dhe informacioneve shpjeguese përkatëse të dhëna nga drejtimi.

Ne do të arrijmë në një konkluzion lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë nga ana e drejtimit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të siguar, do të vlerësojmë nëse ekziston një pasiguri materiale lidhur me ngjarje ose rrethana të cilat mund të hedhin një dyshim të madh për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë. Konkluzionet tona do të bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana të ardhshme mund të bëjnë që entiteti të ndalojë së vijuari veprimtarinë.



TIRANË, 13 QERSHOR 2020

AUDITUES LIGJOR

Bendis Husi



BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rrëgj 368 dt 08.01.2019

"BOREN OIL" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2019
Pasqyra e Pozicionit Financiar

AKTIVET		31 Dhjetor 2019
I	Aktive Afatshkurtra	
1	Mjetet Monetare	
2	Investime	
1)	Ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit	
2)	Aksionet e veta	
3)	Te tjera financiare	
	Totali	
3	Te drejta te arketueshme	
a)	Nga aktiviteti i shfrytezimit	487,094
b)	Nga njesite ekonomike brenda grupit	
c)	Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese	
d)	Te tjera	106,646
e)	Kapital i nenshkruar i papaguar	
	Totali	593,740
4	Inventari	
a)	Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	922,278
b)	Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte	
c)	Produkte te gatshme	
d)	Mallra	
e)	Aktive biologjike (Gje e gjalle ne rritje e majmeri)	
f)	AAGJM te mbajtura per shitje	
g)	Te tjera	
	Totali	1,516,018
5	Shpenzime te shtyra	
6	Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara	
	Total i Aktiveve Afatshkurtra	1,516,018
II	Aktive Afatgjate	
1	Aktive financiare	
a)	Tituj pronesie ne njesite ekonomike brenda grupit	
b)	Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grupit	
c)	Tituj pronesie ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese	
d)	Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese	
e)	Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjate	
	Totali	424,799,368
2	Aktive Afatgjate Materiale	
a)	Toka dhe ndertesa	
b)	Impiante dhe makineri	
c)	Te tjera instalime dhe pajisje	
d)	Parapagime per aktive materiale dhe ne proces	
	Totali	
3	Aktive Biologjike Afatgjate	
4	Aktive Afatgjate Jomateriale	
a)	Koncesione, licensa, marka tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme	
b)	Emer i Mire	
c)	Parapagime per AAJM	
	Totali	
5	Aktive tatimore teshtyra	
	Totali i Aktiveve Afatgjate	424,799,368
	TOTALI AKTIVEVE	426,315,386

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

VILSON DUSHKU

Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

VILSON DUSHKU
Bendis Husi

BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

"BOREN OIL" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2019
Pasqyra e Pozicionit Financiar

PASIVET DHE KAPITALI		31 Dhjetor 2019
I	Detyrimet afatshkurtra	
1	Huamarrjet	
1)	Titujt e huamarrjes	
2)	Detyrimet ndaj institucioneve te kredise	425,682,246
3)	Arketime ne avance per porosi	
4)	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	1,284,893
5)	Deftesa te pagueshme	
6)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit	
7)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemarrrese	
8)	Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetesore	60,434
9)	Te pagueshme per detyrimet tatimore	14,689
10)	Te tjera	99,900
	Totali	427,142,162
4	Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	
5	Te ardhura te shtyra	
6	Provizione	
	Pasive Totale Afatshkurtra	427,142,162
II	Detyrime afatgjata	
1	Huate afatgjata	
1)	Titujt e huamarrjes	
2)	Detyrime ndaj institucioneve te kredise	
3)	Arketimet ne avance per porosi	
4)	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	
5)	Deftesa te pagueshme	
6)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit	
7)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemarrrese	
8)	Te tjera te pagueshme	
	Totali	
2	Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	
3	Te ardhura te shtyra	
4	Provizione:	
1)	Provizione per pensionet	
2)	Provizione te tjera	
4	Detyrime tatimore te shtyra	
	Pasive Totale Afatgjata	427,142,162
	Totali i pasiveve	427,142,162
III	Kapitali	
1)	Kapitali i nenshkruar	100
2)	Primi i lidhur me kapitalin	
3)	Rezerva rivleresimi	
4)	Rezerva te tjera	
a)	Rezerva ligjore	
b)	Rezerva statutore	
c)	Rezerva te tjera	
5)	Fitimi i pashperndare	
6)	Fitimi (humbje) e vitit financiar	(826,876)
	Totali i Kapitalit	(826,776)
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT	426,315,386

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

VILSON DUSHKU

Administrator

VILSON DUSHKU

Hartues i pasqyrave financiare

BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

"BOREN OIL" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2019

Pasqyra e Performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE		31 Dhjetor 2019
1	Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	3,830,596
2	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	-
3	Puna e kryer nga njesia ekonomike dhe e kapitalizuar	-
4	Te ardhura të tjera të shfrytëzimit	-
5	Lenda e pare dhe materiale të konsumueshme	(3,388,709)
a)	Lenda e pare dhe materiale të konsumueshme	(3,388,709)
b)	Te tjera shpenzime	-
6	Shpenzimet e personelit	(707,041)
a)	Pagat dhe shperblimet	(612,344)
b)	Shpenzimet e sigurimeve shoqerore/shendetesore	(94,697)
7	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	-
8	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	-
9	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	(199,374)
10	Te ardhura të tjera	-
a)	Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrëse (paraqitur vecmas të ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)	-
b)	Te ardhura nga investimet dhe huatë të tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur vecmas të ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)	-
c)	Interesa të arketueshem dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur vecmas të ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)	-
11	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra	-
12	Shpenzime financiare	(362,348)
a)	Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet për t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)	-
b)	Shpenzime të tjera financiare	(362,348)
13	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet	(826,876)
14	Fitimi/Humbja para tatimit	(826,876)
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	-
a)	Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	-
b)	Shpenzimi aktual i tatimit fitimit të shtyre	-
c)	Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve	-
16	Fitim (humbje) neto e vitit	(826,876)
17	Fitim (humbje) për:	-
a)	Pronaret e njesise ekonomike meme	-
b)	Interesa jo-kontrolluese	-

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

VILSON DUSHKU

Administrator

VILSON DUSHKU

Hartues i pasqyrave financiare

Bendis Husi

BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

"BOREN OIL" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2019

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare (Metoda Indirekte)

Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	2019
Fitim / Humbja e vitit	(826,876)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:	
Shpenzimet financiare jomonetare	
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	-
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:	
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:	
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(593,740)
Rënie/(ritje) në inventarë	(922,278)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	1,399,482
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	60,434
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(882,978)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve	
Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve	
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera	
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera	
Dividentë të arkëtuara	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar	100
Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral	
Hua të arkëtuara	882,878
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë	
Riblerje e aksioneve të veta	
Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral	
Pagesa e huave	
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare	
Interes i paguar	
Dividendë të paguar	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	882,978
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

VILSON DUSHKU

Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

VILSON DUSHKU
NOIS: [signature]
TIRANë - ALBANIë

BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

"BOREN OIL" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2019

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërdara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa jo kontrolluese	Totali
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2019			-	-	-	-					
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Fitimi / Humbja e vitit									-		-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:								(826,876)	(826,876)		(826,876)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									-		-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	100										
Dividendë të paguar									100		100
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike											
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	100		-	-	-	-	-	(826,876)	(826,776)		(826,776)

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

VILSON DUSHKU

Administrator

VILSON DUSAKU

[Signature]

Hartues i pasqyrave financiare

BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

Bendis Husi
[Signature]

II. SHËNIME PËR DREJTIMIN E SHOQËRISË

Shoqëria "BOREN OIL" shpk, Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, kulla Nr.1, Kati 13 , Tiranë.

Periudha ushtrimore 01 Janar 2019 deri 31 Dhjetor 2019

❖ TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Shoqëria "BOREN OIL" sh.p.k, është regjistruar si shoqëri pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 05 Gusht 2019, me seli në Tiranë me adresë Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla Nr.1, Kati 13.

Krijimi i shoqërisë është bazuar në ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 dhe ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993, përkatësisht "Për Shoqëritë Tregtare" dhe "Për Regjistrin Tregtar". Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi. Ajo është e regjistruar në organet tatimore me NIPT L92005020R.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është tregti me pakice të benzines, naftes, gazit, lubrifikanteve dhe të gjithë produkteve dhe nenprodukteve të tyre. Veprimtari sipermarrje industrial, transport mallrash dhe individesh brenda dhe jashtë vendit; Agjensi informacioni, turistike, konsulence tregtare e shërbime të ngjashme me to. Shërbime hotelerie, restoranti, kafe bar, minimarket; Ne fushen e ndertimit, transportit, tregtimit me shumice e pakice, import eksport mallra, agjensi, servis automjeteve dhe tregtim i pjeseve të automjeteve si dhe cdo aktivitet tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi; Shoqëria mund të zhvillojë cdo aktivitet të ligjshëm, i cili nuk lidhet drejtperdrejtë me aktivitetin e Shoqërisë pa e përcaktuar atë me saktësi, duke ndjekur procedurat përkatëse për shtimin e objektit.

Aktiviteti i shoqërisë është parashikuar të zhvillohet në një afat kohor të përcaktuar.

✓ Kapitali dhe pronësia

Shoqëria "BOREN OIL" shpk, në krijimin e saj ka patur një kapital themeltar 100 lekë të ndarë në 1 pjesë me vlerë nominale 100 lekë.

Shoqëria "BOREN OIL" shpk është një shoqëri e përbërë nga një ortak i vetëm Z. VILSON DUSHKU i cili zotëron nga 100% të pjesëve të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.

✓ Administrimi

Struktura organike, Administrimi, Organizimi, Drejtimi i përshtaten natyrës së shoqërisë dhe realizimit të objektit të veprimtarisë së saj. Shoqëria drejtohet nga Administratori i cili është Z. Vilson Dushku.

BENDIS HUSI
L52222001G

-Nr rregj 368 dt 08.01.2019

❖ PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL.

✓ Mënyra e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në të gjithë aspektet e tyre materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me ligjin Nr.9477 datë 09.02.2006 për "Standardet Kombëtare të Kontabilitetit" si dhe Urdhërin Nr.64 datë 22.07.2014 për "Shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre" të miratuara me urdhër të Ministrit të Financave.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke zbatuar Politikat Kryesore Kontabël:

Politika për njohjen e aktiveve, për njohjen e detyrimeve, njohjen e të drejtave, njohjen e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe vlerësimin e tyre.

Gjatë përgatitjes së Pasqyrave Financiare janë mbajtur parasysh Parimet Bazë të Kontabilitetit si: Parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, Parimi i njësisë ekonomike raportuese, Parimi i vijimësisë si dhe Parimi i kompensimit. Karakteristikat cilësore të përgatitjes së Pasqyrave Financiare të cilat e bëjnë informacionin të dobishëm për përdoruesit dhe që janë përdorur gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare janë: Kuptueshmëria, Rëndësia dhe Materialiteti, Besueshmëria, Parimi i përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formen ligjore, Paanshmëria, Plotësia, Maturia, Qëndrueshmëria dhe Krahueshmëria.

Pasqyrat Financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e Kostos Historike.

Pasqyrat Financiare janë shprehur në monedhën vendase LEKË.

Deklarata e përpuethshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Përmirësuara të Kontabilitetit të cilat janë hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit të Rrepublicës së Shqipërisë dhe të shpallura nga Ministri i Financave.

Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në metodën e kostos historike.

Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur në Lekë, e cila është monedha funksionale për shoqërinë.

Humbje nga rënia në vlerë e aktiveve

Shoqëria teston vlerën e aktiveve të saj financiare rregullisht për të konstatuar rënie të mundshme vlere. Për të përcaktuar nëse një rënie e mundshme vlere duhet njohur në pasqyrën e të ardhurave, Shoqëria gjykon nëse ka ndonjë të dhënë të dallueshme që të ketë një rënie të matshme në flukset monetare të pritshme nga portofoli i aktiveve financiare, përpara se ulja të identifikohet e ekspozuar individualisht në portofol.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të dallueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim jo të favorshëm në gjendjen e pagesave të klientëve në Shoqëri, apo në gjendjen ekonomike kombëtare apo lokale që lidhet me mospagesat në aktivet e Shoqërisë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivet financiare dhe detyrimet për të cilat nuk ka një çmim tregu të dallueshëm, kërkohej përdorimi i teknikave vlerësuese siç përshkruhet në shënimin 4 në pasqyrat financiare.

Përlllogaritja e tatim fitimit

Drejtimi beson se përlllogaritja e kujdesshme e tatimit mbi fitimin duke pasur parasysh ambientin fiskal shqiptar dhe legjislacionin ekzistues në fuqi si dhe rezultatet e mundshme të çdo inspektimi tatimor, nuk do të ketë ndikim sinjifikativ në pozicionin financiar, rezultatin operativ apo flukset monetare të Shoqërisë.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK, kërkon që drejtimi i shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasoje e këtyre çmuarjeve.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në vecanti, informacion mbi elemente të rëndësishme në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare përshkruhen në paragrafët më poshtë.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Mjeteve Monetare**

Bendis Husi
BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

"BOREN OIL" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

Mjetet Monetare përfaqsojnë likuiditetet e njësisë ekonomike në Arkë dhe në Bankë, në llogari rrjedhëse, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide duke ndjekur politikën e Vlerës së Drejtë në zbatim të SKK 3.

(a) Veprimet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetare është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave, përveç diferencave që rrjedhin nga konvertimi i instrumentëve të kapitalit të vlefshme për shitje (nëse ka).

Kurset e këmbimit më të rëndësishme janë :

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2019
Euro	123.42	121.77
Usd	107.82	108.64

(b) Instrumenta financiare

Instrumentë financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përfshijnë llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, dhe llogari të pagueshme. Gjatë periudhave të raportimit shoqëria nuk ka investime në letra me vlerë. Instrumentët financiarë jo-derivativë janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumentëve financiarë joderivativë përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet në rast se Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar përfundojnë, ose të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë regjistruar në datën e tregtimit, psh datën në të cilën Shoqëria zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

BENDIS HUSI
L5222001G
Nr rregj 368 dt 08.01.2019

(c) *Mjete monetare dhe ekuivalente me to*

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në banka. Për qëllime të fluksit të mjeteve monetare, këtu përfshihen edhe depozitat në formën e garancisë për huatë me maturitet më shumë se 3 muaj ose më pak nga data origjinale.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Aktiveve të tjera financiare afatshkurtra**

Aktive të tjera financiare afatshkurtra, kërkesa të arkëtueshme afatshkurtra, letra me vlerë dhe investime të tjera financiare janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale të lëshuara apo dokumentëve të tjerë kontabël. Politika kontabël e ndjekur për aktivet financiare afatshkurtra është sipas kostos së amortizuar (vlerë nominale të kërkesës për arkëtim minus zhvlerësim nëse ka) sipas SKK 3. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave dhe dokumentëve origjinalë kontabël. Llogaritë e aktiveve të tjera financiare afatshkurtra në monedhë të huaj, në datën e mbylljes së bilancit janë vlerësuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2019. Diferencat respektive janë të reflektuara në llogaritë e rezultatit.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Gjendjeve të Inventarit**

Gjendjet e Inventarit të shoqërisë përbëhen nga Mallrat për rishitje të cilat vlerësohen me vlerën më të vogël të kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përfshin materialet direkte dhe punën direkte kur është e aplikueshme dhe kostot e tjera që janë shpenzuar për të sjellë inventarët në gjendjen dhe vendin aktual. Vlera neto e realizuar tregon vlerën e çmuar të çmimit të shitjes në aktivitetin e biznesit, duke i zbritur koston e çmuar të marketingut, shitjes dhe shpërndarjes. Kostoja e inventareve të tjerë është bazuar në parimin FIFO (e hyra e parë e dala e parë) dhe përfshin shpenzimet e përdorura në përvetësimin e inventarit dhe për ti sjellë ato në kushtet dhe vendin e tyre ekzistues. Shuma e përshtatshme për zhvlerësim njihet në pasqyrën e të ardhurave kur ka një evidencë objektive që aktivi është zhvlerësuar. Kosto e inventarit është llogaritur për çdo zë duke përdorur metodën FIFO në zbatim të SKK 4. Në të përfshihen shpenzimet e blerjes së mallrave, shpenzimet e transportit, shpenzimet në doganë, shpenzimet e ngarkim-shkarkimit si dhe çdo shpenzim tjetër i bërë deri në magazinimin e mallrave.

✓ **Rregulla për vlerësimin e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra përfaqsojnë shpenzimet e bëra gjatë vitit financiar por që u përkasin periudhave të ardhshme të njësisë ekonomike. Për to është ndjekur politika kontabël kosto minus zhvlerësim nëse ka, pasqyruar sipas përcaktimit e në zbatim të SKK 1.

Bendis Husi
BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

✓ **Rregullat për vlerësimin e Aktiveve Afatgjata**

Aktivet afatgjata material dhe jomateriale pasqyrohen në bilanc me vlerën e tyre neto.

Aktivet Afatgjatë jomaterialë sipas SKK 5 janë përfshirë në Pasqyrat Financiare duke ndjekur politikën kontabël Kosto e blerjes ose prodhimit ose shumën e rivlerësuar minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin nëse ka.

Aktivet Afatgjatë materialë sipas SKK 5 janë përfshirë në Pasqyrat Financiare duke ndjekur politikën kontabël Kosto e blerjes ose prodhimit ose shumën e rivlerësuar minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin nëse ka. Metoda e llogaritjes së amortizimit bëhet në zbatim të ligjit Nr.8438 datë 28.12.2008 "Për Tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. Baza e llogaritjes së amortizimit bëhet mbi Vlerën Neto Kontabël. Llogaritja e amortizimit për aktivet e hyra gjatë vitit është bërë duke filluar nga data 1 e muajit pasardhës.

1. *Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materialë paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih me poshte) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, (nëse ka).

E gjithë pasuria e paluajtshme, ndërtesat dhe makineritë paraqiten në kosto, historike (sic pershkruhet në paragrafin e mëposhtëm) minus amortizimin përkatës dhe zhvlerësimin, përveç për token, e cila pasqyrohet me koston historike minus zhvlerësimin. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve, punës direkte, si dhe çdo kosto tjetër që lidhet me sjelljen e këtyre aktiveve në gjëndje pune dhe kostot për çmontimin dhe lëvizjen e tyre dhe përgatitjen e vendit në të cilin do të vendosen. Programet kompjuterike të blera që janë të nevojshme për vendosjen në funksion të këtyre aktiveve të cilat kapitalizohen si pjesë të këtyre makinerive. Aktivët të cilat janë nxjerrë jashtë përdorimit kanë qenë të kontabilizuar me vlerën e bazuar në vlerën e tyre neto në datën e daljes jashtë përdorimit. Kostot e pjesëve të ndërrimit për makineritë dhe pajisjet njihen me vlerën e tyre kontabël nëse është e mundur që njësia ekonomike të përfitojë të ardhura ekonomike nga kjo pjesë dhe këto të ardhura mund të maten në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes dhe riparimeve të përditshme të pasurive të paluajtshme, makinerive dhe pajisjeve njihen në fitim e humbje kur ato ndodhin.

2. *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare mbi vlerën e mbetur kontabël në mënyrë që, kosto e cdo aktivi deri në vlerën e mbetur, të shpërndahet përgjatë të gjithë jetës së tij të dobishme si me poshte:

BENDIS HUSI
L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

"BOREN OIL" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

Ndërtesat	5 %
Instalime teknike, makineri e pajisje	20%
Mjete transporti	20%
Mobilje dhe orendi	20%
Pajisje zyre dhe informatike	25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nëse nuk është e pakonsiderueshme) të aktiveve materiale afatgjatë janë rishikuar në datën e raportimit. Toka dhe Ndërtimet në Proçes, si dhe parapagimet furnitorëve nuk amortizohen. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen nga krahasimi i përfitimeve me vlerën e tyre kontabël. Këto përfshihen në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

3. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuhen atij elementi do të rrjedhin Shoqërisë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmeri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

4. Aktivët e marra me qera

Aktivët e marra me qira janë të klasifikuara si qira financiare kur termat e transferimit të risqeve dhe pronësisë kalojnë te qiramarresi. Të gjitha qeratë e tjera janë të klasifikuara si qera operative. Asetet që janë regjistruar si qera financiare regjistrohen si asete të Shoqërisë me vlerën e drejtë në datën e fillimit të qerasë, ose me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qerasë nëse kjo e fundit është më e vogël. Pagesat e qerasë regjistrohen si shpenzime financiare dhe zvogëlimi të detyrimit të qerasë që të arrijë një normë konstante të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimit.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Huamarrjeve Afatshkurtra**

Në huamarrjet afatshkurtra përfshihen huatë (deri në 12 muaj) për financime afatshkurtra si dhe pjesa e huave dhe detyrimeve të qerasë financiare që do të paguhet Brenda 12 muajve të ardhshëm të klasifikuara sipas SKK 3 dhe SKK 7 duke ndjekur politikën kontabël të koston së amortizuar. Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të pakësuar për humbjet për zhvlerësime.

Bendis Husi
BENDIS HUSI
L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

✓ **Rregullat për vlerësimin e Huave dhe Parapagimeve**

Huatë dhe parapagimet janë vlerësuar sipas faturave të blerjes dhe dokumentëve të tjerë origjinalë kontabël. Politika kontabël e ndjekur është në bazë të kostos së amortizuar në zbatim të SKK 3.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Huamarrjeve Afatgjata**

Në huamarrjet afatgjata përfshihen huatë (mbi 12 muaj) për financime afatgjata si dhe pjesa e huave dhe detyrimeve të qerasë financiare që do të paguhen pas 12 muajve të ardhshëm të klasifikuara sipas SKK 3 dhe SKK 7 duke ndjekur politikën kontabël të kostos së amortizuar.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Kapitalit**

Kapitali i shoqërisë vlerësohet sipas vlerës kontabël të kapitalit aksionar të emetuar në krijim të saj, rezervave të krijuara në përputhje me statutin si dhe në përputhje me ligjin "Për Shoqëritë Tregtare" ose ndonjë ligj tjetër të aplikueshëm, fitimeve të pashpërndara që përbëjnë fitimet e akumuluar në vite si dhe fitimi ose humbja e vitit financiar që përbëhet nga fitimi ose humbja në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

✓ **Rregullat e vlerësimit të të Ardhurave**

Të ardhurat përfaqsojnë shitjet neto e rrjedhimisht të ardhurat e përfituara nga shitja e mallrave dhe produkteve, shërbimeve gjatë periudhës kontabël të vlerësuar sipas SKK 8. Ato regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe të lidhjes që kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, panvarësisht se arkëtimi i tyre ose i një pjese prej tyre do të ndodhë në vitin ushtrimor pasardhës. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose për tu arkëtuar dhe përfaqson vlerën e arkëtueshme për të mirat dhe shërbimet e siguruara gjatë aktivitetit normal të shoqërisë, neto nga zbritjet dhe shitjet të lidhura me taksën. Shitjet e mallrave njihen kur mallrat janë dërguar dhe gjithashtu kanë kaluar dhe pronësinë e tyre. E ardhura nga shërbimet e kryera njihet në pasqyrën e të ardhurave në përpjestim me volumin e shërbimit të kryer në datën e bilancit. Vlerësimi i volumit të shërbimit bëhet duke iu referuarurvejimeve të punës së kryer.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Shpenzimeve Direkte**

Shpenzimet e njësishë ekonomike të vitit financiar përfaqsojnë shpenzimet e blerjes së mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara për veprimtarinë parësore, koston e shërbimeve kryesore të vlerësuar me çmimin e blerjes e të vërtetuara me fatura origjinale e dokumentë të tjerë kontabël, shpenzime që lidhen në mënyrë direkte me mallrat ose produktet e destinuar për

shitje. Pagat, shpërblimet dhe kompensimet monetare, sigurimet shoqërore të paguara nga shoqëria të llogaritura mbi pagat që i përkasin periudhës kontabël panvarësisht nëse ato janë paguar ose jo. Shpenzimet për amortizimin që vijnë nga rënia në vlerë e aktiveve afatgjata. Shpenzimet e tjera që janë shpenzimet e papërfshira në zërat e mësipërm por që lidhen me veprimtarinë kryesore të njësisë ekonomike.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Shpenzimeve të Qerasë**

Pagesat e bëra për qeratë operationale njihen në fitim ose humbje me mënyrën lineare gjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së marrë njihen si një pjesë integrale e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë periudhës së qirasë. Minimumi i pagesave të qerasë të bëra nën qeratë financiare janë shpërndarë midis shpenzimeve financiare dhe pakësimit të detyrimit të mbetur. Shpenzimi financiar është shpërndarë në çdo periudhë të termave të qerasë për të krijuar një normë interesi konstante periodike mbi tepicën e mbetur të detyrimit.

✓ **Rregullat e vlerësimit të shpenzimeve (të ardhurave) Financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave. Të ardhurat nga interesi njihen dhe përlllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Të gjitha kostot e huave njihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën e interesit efektiv.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Tatimit mbi Fitimin**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në keto raste tatim fitimi njihet si zë i kapitalit. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet në normën e tatimit që pritet të aplikohet në diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin tatimor që janë ose hyjnë në fuqi në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për atë sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditimet tatimore të papërdorura. Aktiv i tatimor i shtyrë zvogëlohet për atë sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Bendis Husi
BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

✓ **Rregullat e vlerësimit të Fondit të Pensioneve**

Shoqëria paguan kontribute për pensione si dhe kontribute për sigurim shëndetsor për punonjësit e saj siç është parashikuar nga legjislacioni vendas. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtarë përgjegjës për pagesën e pensioneve dhe shërbimeve shëndetsore.

Sigurime shoqërore të detyrueshme

Shoqëria, në rrjedhen normale të biznesit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin lokal. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

Leje vjetore të paguara

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve për gjatë periudhës.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Provizioneve**

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si një rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhje e burimeve duke personifikuar fitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të rregulluar detyrimin dhe një vlerësim të besueshëm të vlerës së detyrimit që mund të bëhet. Nëse efekti është material, provizionet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë, dhe kur është e nevojshme riskun specifik të detyrimit. Provizionet paraqiten në cdo datë bilanci dhe nëse nuk është akoma e mundur që rrjedhja e burimeve duke personifikuar burime ekonomike të përdoret për rregullimet e detyrimeve, provizionet anulohen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje shfrytëzuese të ardhme. Aktivitetet dhe detyrimet e rastit nuk njihen.

✓ **Rregullat e Menaxhimit të Riskut Financiar**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumentave financiare:

Bendis Husi

BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

- Risku i kredisë
- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut

Menaxhimi mbart përgjegjësinë për vendosjen dhe mbikqyrjen e politikave të shoqërisë për menaxhimin e riskut. Këto politika duhet të rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e shoqërisë. Instrumentat financiarë kryesorë të shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në bankë, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme si dhe detyrime të tjera afatshkurtra.

Risku i kredisë

Në varësi të volumit të llogarive të arkëtueshme përcaktohet dhe risku i kredisë. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme mbahet në shumën e konsideruar të nevojshme për të mbuluar riskun potencial në mbledhjen e tepricave të llogarive të arkëtueshme.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj lidhur me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është i qënësishëm në shoqëri dhe menaxhohet duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet për flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Risku i tregut

Përbëhet nga risku i normave të interest dhe risku i kursit të këmbimit.

Risku i normave të interesit

Shoqëria përballlet me riskun e normës së interest të flukseve të parasë në lidhje me hua dhe overdraft që ajo merr me normë variabël.

Risku i kursit të këmbimit

Llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme në monedhë të huaj apo huatë janë faktorë që e ekspozojnë shoqërinë ndaj riskut të kursit të këmbimit.

Analiza e ndjeshmërisë

Duke administruar riskun e normave të interest dhe të pozicionit valuator, shoqëria mund të reduktojë ndikimet e luatjeve afatshkurtra në fitimet e saj. Në periudha afatgjata sidoqoftë menaxhimi i këtyre risqeve mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në fitim.

Administrimi i Kapitalit

Politikat e shoqërisë janë të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit.

Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse evidenca objektive zhvlerësimi tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivit financiar.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të vlefshëm për shitje është llogaritur kundrejt vlerës së tij të drejtë. Aktivet financiare të cilat janë të konsiderueshme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet së bashku në grupe që mbartin karakteristika të ngjashme risku. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Ndonjë humbje kumulative në lidhje me aktivet financiare të vlefshme për shitje të njohura me parë në letra me vlerë transferohet tek humbje fitimi. Një humbje nga zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Anullimi njihet në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga zhvlerësimi në periudhat e mëparshme janë rishikuar në çdo datë raportimi për rastet kur humbja rritet ose nuk ekziston më. Një humbje zhvlerësimi anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura

për caktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

Kontabiliteti mbrojtës dhe instrumentat derivativë financiarë

Shoqëria nuk përdor instrumenta financiare mbrojtëse, panvarësisht se është e ekspozuar ndaj riskut financiar.

❖ ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me ligjin Nr.9477 datë 09.02.2006 dhe me SKK 2, Shoqëria ka ndërtuar një plan vetjak të llogarive në përputhje dhe në zbatim të SKK të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Departamenti i Financës përbëhet nga disa specialist finance. Kontabiliteti mbahet në mënyrë të informatizuar nëpërmjet programit të Kontabilitetit "Programi Alpha Platinum".

❖ SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE


Bendis Husi

BENDIS HUSI
L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019.

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR
PERIUDHA 01.01.2018 – 31.12.2018

“AZ DISTRIBUTION” SHPK



11 PRILL 2019

AUDITUES LIGJOR
BENDIS HUSI



PËRMBAJTJA


I. RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

II. PASQYRAT FINANCIARE 31.12.2018

- ❖ PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)
- ❖ PASQYRA E PERFORMANCËS (PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE)
- ❖ PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE
- ❖ PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO

III. SHËNIME PËR DREJTIMIN E SHOQËRISË

- ❖ TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SHOQËRINË
- ❖ PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL
- ❖ ORGANIZIMI I KONTABILITETIT
- ❖ SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE



I. RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR
MBI AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË

"AZ DISTRIBUTION" sh.p.k

DREJTUAR: Z. FATJON MITA!

Ortak i vetëm i shoqërisë "AZ DISTRIBUTION" shpk, Rruga "Nikolla Tupe", Pallati Nr.1, Ap.4, Kati 4, Numër pasurie 31124+1-4, Zona kadastrale Nr.8270, Vol 73, Faqe 203, Tiranë.

Lidhur me shqyrtimin e Pasqyrave Financiare të periudhës janar-dhjetor 2018.

I NDERUAR ZOTËRI!

OPINIONI


Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "AZ DISTRIBUTION" shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë "AZ DISTRIBUTION" shpk me datën 31 Dhjetor 2018, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

BAZA PËR OPINIONIN

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Profesionistëve Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (kodi i BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e

BENDIS HUSI
L5222001G
Nr rregj 368 dt 08.01.2019



Bendis Husi

"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

PËRGJEGJËSITË E DREJTIMIT NË LIDHJE ME PASQYRAT FINANCIARE

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.


Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Ne do të ushtrojmë gjykimin tonë profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit, në pajtim me SNA-të.

Ne do të identifikojmë dhe të vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, do të hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve si dhe, do të marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse

BENDIS HUSI
L52222001G
Nr rregj 368 dt 08.01.2019

Bendis Husi



"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR


mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontroleve të brendshme. Ne do të sigurojmë njohjen dhe kuptimin për kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin, në mënyrë që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion lidhur me efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm të entitetit.

Ne do të vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e çmuarjeve (vlerësimeve) kontabël dhe informacioneve shpjeguese përkatëse të dhëna nga drejtimi.


Ne do të arrijmë në një konkluzion lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë nga ana e drejtimit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të siguar, do të vlerësojmë nëse ekziston një pasiguri materiale lidhur me ngjarje ose rrethana të cilat mund të hedhin një dyshim të madh për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë. Konkluzionet tona do të bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana të ardhshme mund të bëjnë që entiteti të ndalojë së vijuari veprimtarinë.

TIRANË, 11 PRILL 2019

AUDITUES LIGJOR



BENDIS HUSHI
L5222001G
Nr rregj 368 dt 08.01.2019



"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2018
Pasqyra e Pozicionit Financiar

A K T I V E T		31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
I	Aktive Afatshkurtra		
1	Mjetet Monetare		
2	Investime	6,048,073	8,136,158
1)	Ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit		
2)	Aksionet e veta		
3)	Te tjera financiare		
	Totali		
3	Te drejta te arketueshme		
a)	Nga aktiviteti i shfrytezimit		
b)	Nga njesite ekonomike brenda grupit	433,209,914	213,873,618
c)	Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese		
d)	Te tjera		
e)	Kapital i nenshkruar i papaguar	1,844,021	655,775,286
	Totali		
4	Inventari	435,053,935	869,648,904
a)	Lende e pare dhe materiale te konsumueshme		
b)	Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte		
c)	Produkte te gatshme		
d)	Mallra		
e)	Aktive biologjike (Gje e gjalle ne rritje e majmeri)	25,630,889	20,696,298
f)	AAGJM te mbajtura per shitje		
g)	Parapagime per inventar		
	Totali	3,918,718	
5	Shpenzime te shtyra	29,549,607	20,696,298
6	Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara	117,400	54,172,660
	Totali i Aktiveve Afatshkurtra		117,400
II	Aktive Afatgjata	470,769,015	952,771,420
1	Aktive financiare		
a)	Tituj pronesie ne njesite ekonomike brenda grupit		
b)	Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grupit		
c)	Tituj pronesie ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese		
d)	Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese		
e)	Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjata		
	Totali	281,130,960	
2	Aktive Afatgjata Materiale	281,130,960	
a)	Toka dhe ndertesa		
b)	Impiante dhe makineri	540,533,496	507,791,451
c)	Te tjera instalime dhe pajisje	4,500,597	3,300,597
d)	Mjete transporti	133,388,821	14,136,336
e)	Parapagime per aktive materiale dhe ne proces	3,461,240	3,461,240
	Totali	681,884,154	528,689,624
3	Aktive Biologjike Afatgjate		
4	Aktive Afatgjata Jomateriale		
a)	Koncesione, licensa, marka tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme	1,048,833	1,048,833
b)	Emer i Mire		
c)	Parapagime per AAJM		
	Totali	1,048,833	1,048,833
5	Aktive tatimore teshtyra		
	Totali i Aktiveve Afatgjata	964,063,947	529,738,457
	TOTALI AKTIVEVE	1,434,832,962	1,482,509,877

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

FATJON MITA

Administratör

BËNDIS HUSI

L5222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

Hartues i pasqyrave financiare



"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2018
Pasqyra e Pozicionit Financiar

PASIVET DHE KAPITALI		31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
I	Detyrimet afatshkurtra		
1	Huamarrjet		
1)	Titujt e huamarrjes		
2)	Detyrimet ndaj institucioneve te kredise		
3)	Arketime ne avance per porosi	150,536,254	794,552,070
4)	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit		
5)	Deftesa te pagueshme	216,094,865	288,917,191
6)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit		
7)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemarrrese		
8)	Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetesore	1,826,055	1,912,641
9)	Te pagueshme per detyrimet tatimore	167,181	397,324
10)	Te tjera		
	Totali	368,099,061	5,412,996
4	Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		1,091,105,636
5	Te ardhura te shtyra		
6	Provizione		
	Pasive Totale Afatshkurtra	368,099,061	1,091,105,636
II	Detyrime afatgjata		
1	Huate afatgjata		
1)	Titujt e huamarrjes		
2)	Detyrime ndaj institucioneve te kredise		
3)	Arketimet ne avance per porosi	680,724,774	
4)	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit		
5)	Deftesa te pagueshme		
6)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit		
7)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemarrrese		
8)	Te tjera te pagueshme		
	Totali	680,724,774	
2	Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
3	Te ardhura te shtyra		
4	Provizione:		
1)	Provizione per pensionet		
2)	Provizione te tjera		
4	Detyrime tatimore te shtyra		
	Pasive Totale Afatgjata		
	Totali i pasiveve	680,724,774	1,091,105,636
III	Kapitali		
1)	Kapitali i nenshkruar		
2)	Primi i lidhur me kapitalin	466,194,300	466,194,300
3)	Rezerva rivleresimi		
4)	Rezerva te tjera		
a)	Rezerva ligjore		
b)	Rezerva statutore		
c)	Rezerva te tjera		
5)	Fitimi i pashperndare	(76,829,784)	(75,114,905)
6)	Fitimi (humbje) e vitit financiar	(3,355,389)	324,846
	Totali i Kapitalit	386,009,127	391,404,241
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT	1,434,832,962	1,482,509,877

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

FATJON MITA


Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019



"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2018

Pasqyra e Performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE		31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
1	Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	675,684,082	648,562,634
2	Ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit ne proces		
3	Puna e kryer nga njesia ekonomike dhe e kapitalizuar		
4	Te ardhura te tjera te shfrytëzimit	1,772,217	93,333
5	Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		
a)	Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	586,685,824	554,789,846
b)	Te tjera shpenzime		
6	Shpenzimet e personelit	32,185,794	28,292,144
a)	Pagat dhe shperblimet	27,713,258	24,402,577
b)	Shpenzimet e sigurimeve shoqerore/shendetesore	4,472,536	3,889,567
7	Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		
8	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	707	3,388,919
9	Shpenzime te tjera shfrytëzimi	69,096,086	68,002,041
		(10,512,112)	(5,816,983)
10	Te ardhura te tjera	8,216,098	44,801,798
a)	Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrëse(paraqitur vecmas te ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)	8,216,098	6,290,879
b)	Te ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjese e aktiveve afatgjata(paraqitur vecmas te ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)		
c)	Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme(paraqitur vecmas te ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)		
11	Zhvleresimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra		38,510,919
12	Shpenzime financiare		
a)	Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme(paraqitur vecmas shpenzimet per t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)	1,001,675	38,554,249
b)	Shpenzime te tjera financiare		38,510,918
		1,001,675	43,331
13	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesemarrjet	7,214,423	6,247,549
14	Fitimi/Humbja para tatimit	(3,297,689)	430,566
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin		
a)	Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	57,700	105,720
b)	Shpenzimi aktual i tatimit fitimit te shtyre	57,700	105,720
c)	Pjesa e tatimit fitimit te pjesemarrjeve		
16	Fitim (humbje) neto e vitit		
17	Fitim (humbje) per:	(3,355,389)	324,846
a)	Pronaret e njesise ekonomike meme		
b)	Interesa jo-kontrolluese		

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,


FATJON MITA

Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

BENDIS HUSI
L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019



"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2018

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare (Metoda Indirekte)

Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	2018	2017
Fitim / Humbja e vitit	(3,355,389)	324,846
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	707	3,388,919
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		
Rënie/(ritje) në inventarë	488,767,629	(539,119,217)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(8,853,309)	(1,095,337)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(78,465,465)	203,483,769
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(525,294)	(86,586)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	397,568,879	(333,103,607)
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve		
Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(434,325,490)	(21,613,253)
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera	-	349,598,556
Dividentë të arkëtuara		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(434,326,197)	324,596,384
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar	34,669,233	
Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral	(2,039,725)	
Hua të arkëtuara		
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë	680,724,774	13,603,483
Riblerje e aksioneve të veta		
Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		
Pagesa e huave		
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare	(644,015,816)	
Interes i paguar		
Dividendë të paguar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	34,669,233	13,603,483
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(2,088,085)	5,096,260
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	8,136,158	3,039,898
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	6,048,073	8,136,158

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

FATJON MITA


Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

BENDIS HUSI

L52222001G

Nr i regj 368 dt 08.01.2019



"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2018
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2017	100,000	466094300	-	-	-	-	(75,333,062)	218,157	391,079,395	-	391,079
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:											
Fitimi / Humbja e vitit											
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:								324,846	-		-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									-		-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar									-		-
Dividendë të paguar									-		-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									-		-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	100,000	466,094,300	-	-	-	-	(75,114,905)	324,846	391,404,241	-	391,404,2
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2018	100,000	466,094,300	-	-	-	-	(75,114,943)	324,846	391,404,203	-	391,404,2
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:											
Fitimi / Humbja e vitit									-		-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:								(3,355,389)	(3,355,389)		(3,355,389)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									-		-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar									-		-
Dividendë të paguar									-		-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									-		-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100,000	466,094,300	-	-	-	-	(76,829,784)	(3,355,389)	386,009,127	-	386,009,12

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

FATJON MITA


Administrator

BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

Hartues i pasqyrave financiare



II. SHËNIME PËR DREJTIMIN E SHOQËRISË

Shoqëria "AZ DISTRIBUTION" shpk, Rruga "Nikolla Tupe", Pallati Nr.1, Ap.4, Kati 4, Numër pasurie 31124+1-4, Zona kadastrale Nr.8270, Vol 73, Faqe 203, Tiranë.

Periudha ushtrimore 01 Janar 2018 deri 31 Dhjetor 2018

❖ TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Shoqëria "AZ DISTRIBUTION" sh.p.k, është regjistruar si shoqëri pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 04 Tetor 2013, me seli në Tiranë me adresë Rruga "Nikolla Tupe", Pallati Nr.1, Ap.4, Kati 4, Numër pasurie 31124+1-4, Zona kadastrale Nr.8270, Vol 73, Faqe 203.

Krijimi i shoqërisë është bazuar në ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 dhe ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993, përkatësisht "Për Shoqëritë Tregtare" dhe "Për Regjistrin Tregtar". Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi. Ajo është e regjistruar në organet tatimore me NIPT L32204031E.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është tregtimi karburantit të ndryshëm me pakicë, si dhe vajrave lubrifikante, të gazit të lëngshëm për ngrohje, pajisje ngrohëse gazi, si dhe mbushjen e bomblave të gazit dhe tregtimi i tyre me pakicë.

Aktiviteti i shoqërisë është parashikuar të zhvillohet në një afat kohor të papërcaktuar.

✓ Kapitali dhe pronësia

Shoqëria "AZ DISTRIBUTION" shpk, në krijimin e saj ka patur një kapital themeltar 100,000 lekë të ndarë në 100 pjesë me vlerë nominale 1,000 secila.

Shoqëria "AZ DISTRIBUTION" shpk është një shoqëri e përbërë nga një ortak i vetëm Z. Fatjon Mita i cili zotëron nga 100% të pjesëve të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.

Me vendim të asamblesë së ortakëve kapitali i shoqërisë është rritur në 466,194,300 lekë, i ndarë në 1 pjesë me vlerë nominale 466,194,300 lekë/pjesa. Ndryshimet e fundit në kapitalin e nënshkruar janë rregjistruar në QKB në datën 20.10.2017

✓ Administrimi

Struktura organike, Administrimi, Organizimi, Drejtimi i përshtaten natyrës së shoqërisë dhe realizimit të objektit të veprimtarisë së saj. Shoqëria drejtohet nga Administratori e cila është Z. Fatjon Mita.



❖ PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL.

✓ Mënyra e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në të gjithë aspektet e tyre materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me ligjin Nr.9477 datë 09.02.2006 për "Standardet Kombëtare të Kontabilitetit" si dhe Urdhërin Nr.64 datë 22.07.2014 për "Shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre" të miratuara me urdhër të Ministrit të Financave.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke zbatuar Politikat Kryesore Kontabël:

Politika për njohjen e aktiveve, për njohjen e detyrimeve, njohjen e të drejtave, njohjen e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe vlerësimin e tyre.

Gjatë përgatitjes së Pasqyrave Financiare janë mbajtur parasysh Parimet Bazë të Kontabilitetit si: Parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, Parimi i njësisë ekonomike raportuese, Parimi i vijimësisë si dhe Parimi i kompensimit. Karakteristikat cilësore të përgatitjes së Pasqyrave Financiare të cilat e bëjnë informacionin të dobishëm për përdoruesit dhe që janë përdorur gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare janë: Kuptueshmëria, Rëndësia dhe Materialiteti, Besueshmëria, Parimi i përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formen ligjore, Paanshmëria, Plotësia, Maturia, Qëndrueshmëria dhe Krahueshmëria.

Pasqyrat Financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e Kostos Historike.

Pasqyrat Financiare janë shprehur në monedhën vendase LEKË.

Deklarata e përpuethshmërisë


Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Përmirësuara të Kontabilitetit të cilat janë hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit të Rrepublicës së Shqipërisë dhe të shpallura nga Ministri i Financave.

Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në metodën e kostos historike.

Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur në Lekë, e cila është monedha funksionale për shoqërinë.



Humbje nga rënia në vlerë e aktiveve

Shoqëria teston vlerën e aktiveve të saj financiare rregullisht për të konstatuar rënie të mundshme vlere. Për të përcaktuar nëse një rënie e mundshme vlere duhet njohur në pasqyrën e të ardhurave, Shoqëria gjykon nëse ka ndonjë të dhënë të dallueshme që të ketë një rënie të matshme në flukset monetare të pritshme nga portofoli i aktiveve financiare, përpara se ulja të identifikohet e ekspozuar individualisht në portofol.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të dallueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim jo të favorshëm në gjendjen e pagesave të klientëve në Shoqëri, apo në gjendjen ekonomike kombëtare apo lokale që lidhet me mospagesat në aktivet e Shoqërisë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivet financiare dhe detyrimet për të cilat nuk ka një çmim tregu të dallueshëm, kërkohej përdorimi i teknikave vlerësuese siç përshkruhet në shënimin 4 në pasqyrat financiare.

Përlllogaritja e tatim fitimit

Drejtimi beson se përlllogaritja e kujdesshme e tatimit mbi fitimin duke pasur parasysh ambientin fiskal shqiptar dhe legjislacionin ekzistues në fuqi si dhe rezultatet e mundshme të cdo inspektimi tatimor, nuk do të ketë ndikim sinjifikativ në pozicionin financiar, rezultatin operativ apo flukset monetare të Shoqërisë.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK, kërkon që drejtimi i shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasoje e këtyre çmuarjeve.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në vecanti, informacion mbi elemente të rëndësishme në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare përshkruhen në paragrafët më poshtë.

✓ Rregullat për vlerësimin e Mjeteve Monetare

"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

Mjetet Monetare përfaqsojnë likuiditetet e njësisë ekonomike në Arkë dhe në Bankë, në llogari rrjedhëse, investime në tregun e parësë dhe tregje të tjera shumë likuide duke ndjekur politikën e Vlerës së Drejtë në zbatim të SKK 3.

(a) Veprimet në monedhë të huaj


Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetare është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave, përveç diferencave që rrjedhin nga konvertimi i instrumentëve të kapitalit të vlefshme për shitje (nëse ka).

Kurset e këmbimit më të rëndësishme janë :

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2018
Euro	132.95	123.42
Usd	111.10	107.82

(b) Instrumenta financiare

Instrumentë financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përfshijnë llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, dhe llogari të pagueshme. Gjatë periudhave të raportimit shoqëria nuk ka investime në letra me vlerë. Instrumentët financiarë jo-derivativë janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumentëve financiarë joderivativë përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet në rast se Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar përfundojnë, ose të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë regjistruar në datën e tregtimit, psh datën në të cilën Shoqëria zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.



(c) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në banka. Për qëllime të fluksit të mjeteve monetare, këtu përfshihen edhe depozitat në formën e garancisë për huatë me maturitet më shumë se 3 muaj ose më pak nga data origjinale.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Aktiveve të tjera financiare afatshkurtra**

Aktive të tjera financiare afatshkurtra, kërkesa të arkëtueshme afatshkurtra, letra me vlerë dhe investime të tjera financiare janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale të lëshuara apo dokumentëve të tjerë kontabël. Politika kontabël e ndjekur për aktivet financiare afatshkurtra është sipas kostos së amortizuar (vlerë nominale të kërkesës për arkëtim minus zhvlerësim nëse ka) sipas SKK 3. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave dhe dokumentëve origjinalë kontabël. Llogaritë e aktiveve të tjera financiare afatshkurtra në monedhë të huaj, në datën e mbylljes së bilancit janë vlerësuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2018. Diferencat respektive janë të reflektuara në llogaritë e rezultatit.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Gjendjeve të Inventarit**

Gjendjet e Inventarit të shoqërisë përbëhen nga Mallrat për rishitje të cilat vlerësohen me vlerën më të vogël të kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përfshin materialet direkte dhe punën direkte kur është e aplikueshme dhe kostot e tjera që janë shpenzuar për të sjellë inventarët në gjendjen dhe vendin aktual. Vlera neto e realizuar tregon vlerën e çmuar të çmimit të shitjes në aktivitetin e biznesit, duke i zbritur koston e çmuar të marketingut, shitjes dhe shpërndarjes. Kostoja e inventareve të tjerë është bazuar në parimin FIFO (e hyra e parë e dala e parë) dhe përfshin shpenzimet e përdorura në përvetësimin e inventarit dhe për ti sjellë ato në kushtet dhe vendin e tyre ekzistues. Shuma e përshtatshme për zhvlerësim njihet në pasqyrën e të ardhurave kur ka një evidencë objektive që aktivi është zhvlerësuar. Kosto e inventarit është llogaritur për çdo zë duke përdorur metodën FIFO në zbatim të SKK 4. Në të përfshihen shpenzimet e blerjes së mallrave, shpenzimet e transportit, shpenzimet në doganë, shpenzimet e ngarkim-shkarkimit si dhe çdo shpenzim tjetër i bërë deri në magazinimin e mallrave.

✓ **Rregulla për vlerësimin e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra përfaqsojnë shpenzimet e bëra gjatë vitit financiar por që u përkasin periudhave të ardhshme të njësisë ekonomike. Për to është ndjekur politika kontabël kosto minus zhvlerësim nëse ka, pasqyruar sipas përcaktimit e në zbatim të SKK 1.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Aktiveve Afatgjata**

Aktivet afatgjata material dhe jomateriale pasqyrohen në bilanc me vlerën e tyre neto.

Aktivet Afatgjatë jomaterialë sipas SKK 5 janë përfshirë në Pasqyrat Financiare duke ndjekur politikën kontabël Kosto e blerjes ose prodhimit ose shumën e rivlerësuar minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin nëse ka.

Aktivet Afatgjatë materialë sipas SKK 5 janë përfshirë në Pasqyrat Financiare duke ndjekur politikën kontabël Kosto e blerjes ose prodhimit ose shumën e rivlerësuar minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin nëse ka. Metoda e llogaritjes së amortizimit bëhet në zbatim të ligjit Nr.8438 datë 28.12.2008 "Për Tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. Baza e llogaritjes së amortizimit bëhet mbi Vlerën Neto Kontabël. Llogaritja e amortizimit për aktivet e hyra gjatë vitit është bërë duke filluar nga data 1 e muajit pasardhës.

1. Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materialë paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih me poshte) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, (nëse ka).

E gjithë pasuria e paluajtshme, ndërtesat dhe makineritë paraqiten në kosto, historike (sic pershkruhet në paragrafin e mëposhtëm) minus amortizimin përkatës dhe zhvlerësimin, përveç për token, e cila pasqyrohet me koston historike minus zhvlerësimin. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijne kostot e materialeve, punës direkte, si dhe çdo kosto tjetër që lidhet me sjelljen e këtyre aktiveve në gjëndje pune dhe kostot për çmontimin dhe lëvizjen e tyre dhe përgatitjen e vendit në të cilin do të vendosen. Programet kompjuterike të blera që janë të nevojshme për vendosjen në funksion të këtyre aktiveve të cilat kapitalizohen si pjesë të këtyre makinerive. Aktivët të cilat janë nxjerrë jashtë përdorimit kanë qenë të kontabilizuar me vlerën e bazuar në vlerën e tyre neto në datën e daljes jashtë përdorimit. Kostot e pjesëve të ndërrimit për makineritë dhe pajisjet njihen me vlerën e tyre kontabël nëse është e mundur që njësia ekonomike të përfitojë të ardhura ekonomike nga kjo pjesë dhe këto të ardhura mund të maten në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes dhe riparimeve të përditshme të pasurive të paluajtshme, makinerive dhe pajisjeve njihen në fitim e humbje kur ato ndodhin.

2. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare mbi vlerën e mbetur kontabël në mënyrë që, kosto e cdo aktivi deri në vlerën e mbetur, të shpërndahet përgjatë të gjithë jetës së tij të dobishme si me poshte:

"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

Ndërtesat	5 %
Instalime teknike, makineri e pajisje	20%
Mjete transporti	20%
Mobilje dhe orendi	20%
Pajisje zyre dhe informatike	25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nëse nuk është e pakonsiderueshme) të aktiveve materiale afatgjatë janë rishikuar në datën e raportimit. Toka dhe Ndërtimet në Proçes, si dhe parapagimet furnitorëve nuk amortizohen.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen nga krahasimi i përfitimeve me vlerën e tyre kontabël. Këto përfshihen në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

3. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuhen atij elementi do ti rrjedhin Shoqërisë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmeri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.


4. Aktivët e marra me qera

Aktivët e marra me qira janë të klasifikuara si qira financiare kur termat e transferimit të risqeve dhe pronësisë kalojnë te qiramarresi, Të gjitha qeratë e tjera janë të klasifikuara si qera operative. Asetet që janë rregjistruar si qera financiare rregjistrohen si asete të Shoqërisë me vlerën e drejtë në datën e fillimit të qerasë, ose me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qerasë nëse kjo e fundit është më e vogël. Pagesat e qerasë regjistrohen si shpenzime financiare dhe zvogëlimit të detyrimit të qerasë që të arrijë një normë konstante të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimit.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Huamarrjeve Afatshkurtra**

Në huamarrjet afatshkurtra përfshihen huatë (deri në 12 muaj) për financime afatshkurtra si dhe pjesa e huave dhe detyrimeve të qerasë financiare që do të paguhet Brenda 12 muajve të ardhshëm të klasifikuara sipas SKK 3 dhe SKK 7 duke ndjekur politikën kontabël të koston së amortizuar. Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të pakësuar për humbjet për zhvlerësime.

BENDIS HUSI
L52222001G
Nr rregj 368 dt 08.01.2019



✓ **Rregullat për vlerësimin e Huave dhe Parapagimeve**

Huatë dhe parapagimet janë vlerësuar sipas faturave të blerjes dhe dokumentëve të tjerë origjinalë kontabël. Politika kontabël e ndjekur është në bazë të kostos së amortizuar në zbatim të SKK 3.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Huamarrjeve Afatgjata**

Në huamarrjet afatgjata përfshihen huatë (mbi 12 muaj) për financime afatgjata si dhe pjesa e huave dhe detyrimeve të qerasë financiare që do të paguhen pas 12 muajve të ardhshëm të klasifikuara sipas SKK 3 dhe SKK 7 duke ndjekur politikën kontabël të kostos së amortizuar.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Kapitalit**

Kapitali i shoqërisë vlerësohet sipas vlerës kontabël të kapitalit aksionar të emetuar në krijim të saj, rezervave të krijuara në përputhje me statutin si dhe në përputhje me ligjin "Për Shoqëritë Tregtare" ose ndonjë ligj tjetër të aplikueshëm, fitimeve të pashpërndara që përbëjnë fitimet e akumuluar në vite si dhe fitimi ose humbja e vitit financiar që përbëhet nga fitimi ose humbja në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

✓ **Rregullat e vlerësimit të të Ardhurave**

Të ardhurat përfaqsojnë shitjet neto e rrjedhimisht të ardhurat e përfituara nga shitja e mallrave dhe produkteve, shërbimeve gjatë periudhës kontabël të vlerësuar sipas SKK 8. Ato regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe të lidhjes që kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, panvarësisht se arkëtimi i tyre ose i një pjese prej tyre do të ndodhë në vitin ushtrimor pasardhës. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose për tu arkëtuar dhe përfaqson vlerën e arkëtueshme përtë mirat dhe shërbimet e siguruara gjatë aktivitetit normal të shoqërisë, neto nga zbritjet dhe shitjet të lidhura me taksën. Shitjet e mallrave njihen kur mallrat janë dërguar dhe gjithashtu kanë kaluar dhe pronësinë e tyre. E ardhura nga shërbimet e kryera njihet në pasqyrën e të ardhurave në përpjestim me volumin e shërbimit të kryer në datën e bilancit. Vlerësimi i volumit të shërbimit bëhet duke iu referuarurvejimeve të punës së kryer.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Shpenzimeve Direkte**

Shpenzimet e njësisë ekonomike të vitit financiar përfaqsojnë shpenzimet e blerjes së mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara për veprimtarinë parësore, koston e shërbimeve kryesore të vlerësuar me çmimin e blerjes e të vërtetuara me fatura origjinale e dokumentë të tjerë kontabël, shpenzime që lidhen në mënyrë direkte me mallrat ose produktet e destinuar për

shitje. Pagat, shpërblimet dhe kompensimet monetare, sigurimet shoqërore të paguara nga shoqëria të llogaritura mbi pagat që i përkasin periudhës kontabël panvarësisht nëse ato janë

paguar ose jo. Shpenzimet për amortizimin që vijnë nga rënia në vlerë e aktiveve afatgjata. Shpenzimet e tjera që janë shpenzimet e papërfshira në zërat e mësipërm por që lidhen me veprimtarinë kryesore të njësisë ekonomike.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Shpenzimeve të Qerasë**

Pagesat e bëra për qeratë operationale njihen në fitim ose humbje me mënyrën lineare gjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së marrë njihen si një pjesë integrale e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë periudhës së qirasë. Minimumi i pagesave të qerasë të bëra nën qeratë financiare janë shpërndarë midis shpenzimeve financiare dhe pakësimit të detyrimit të mbetur. Shpenzimi financiar është shpërndarë në çdo periudhë të termave të qerasë për të krijuar një normë interesi konstante periodike mbi tepricën e mbetur të detyrimit.

✓ **Rregullat e vlerësimit të shpenzimeve (të ardhurave) Financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave. Të ardhurat nga interesi njihen dhe përlllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Të gjitha kostot e huave njihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën e interesit efektiv.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Tatimit mbi Fitimin**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në keto raste tatim fitimi njihet si zë i kapitalit. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet në normën e tatimit që pritet të aplikohet në diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin tatimor që janë ose hyjnë në fuqi në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditimet tatimore të papërdorura. Aktiv i tatimor i shtyrë zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Fondit të Pensioneve**

Shoqëria paguan kontribute për pensione si dhe kontribute për sigurim shëndetsor për punonjësit e saj siç është parashikuar nga legjislacioni vendas. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtarë përgjegjës për pagesën e pensioneve dhe shërbimeve shëndetsore.

Sigurime shoqërore të detyrueshme

Shoqëria, në rrjedhen normale të biznesit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin lokal. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

Leje vjetore të paguara

Shoqëria njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve për gjatë periudhës.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Provizioneve**

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si një rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhje e burimeve duke personifikuar fitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të rregulluar detyrimin dhe një vlerësim të besueshëm të vlerës së detyrimit që mund të bëhet. Nëse efekti është material, provizionet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë, dhe kur është e nevojshme riskun specifik të detyrimit. Provizionet paraqiten në cdo datë bilanci dhe nëse nuk është akoma e mundur që rrjedhja e burimeve duke personifikuar burime ekonomike të përdoret për rregullimet e detyrimeve, provizionet anulohen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje shfrytëzuese të ardhme. Aktivitetet dhe detyrimet e rastit nuk njihen.

✓ **Rregullat e Menaxhimit të Riskut Financiar**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumentave financiarë:

"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

- Risku i kredisë
- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut

Menaxhimi mbart përgjegjësinë për vendosjen dhe mbikqyrjen e politikave të shoqërisë për menaxhimin e riskut. Këto politika duhet të rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e shoqërisë. Instrumentat financiarë kryesorë të shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në bankë, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme si dhe detyrime të tjera afatshkurtra.

Risku i kredisë

Në varësi të volumit të llogarive të arkëtueshme përcaktohet dhe risku i kredisë. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme mbahet në shumën e konsideruar të nevojshme për të mbuluar riskun potencial në mbledhjen e tepricave të llogarive të arkëtueshme.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj lidhur me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është i qënësishëm në shoqëri dhe menaxhohet duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet për flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Risku i tregut


Përbëhet nga risku i normave të interest dhe risku i kursit të këmbimit.

Risku i normave të interesit

Shoqëria përballlet me riskun e normës së interest të flukseve të parasë në lidhje me hua dhe overdraft që ajo merr me normë variabël.

Risku i kursit të këmbimit

Llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme në monedhë të huaj apo huatë janë faktorë që e ekspozojnë shoqërinë ndaj riskut të kursit të këmbimit.



Analiza e ndjeshmërisë

Duke administruar riskun e normave të interest dhe të pozicionit valuator, shoqëria mund të reduktojë ndikimet e luatjeve afatshkurtra në fitimet e saj. Në periudha afatgjata sidoqoftë menaxhimi i këtyre risqeve mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në fitim.

Administrimi i Kapitalit

Politikat e shoqërisë janë të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit.

Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse evidenca objektive zhvlerësimi tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivit financiar.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të vlefshëm për shitje është llogaritur kundrejt vlerës së tij të drejtë. Aktivet financiare të cilat janë të konsiderueshme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet së bashku në grupe që mbartin karakteristika të ngjashme risku. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Ndonjë humbje kumulative në lidhje me aktivet financiare të vlefshme për shitje të njohura me parë në letra me vlerë transferohet tek humbje fitimi. Një humbje nga zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Anullimi njihet në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga zhvlerësimi në periudhat e mëparshme janë rishikuar në çdo datë raportimi për rastet kur humbja rritet ose nuk ekziston më. Një humbje zhvlerësimi anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për caktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa

vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.


Kontabiliteti mbrojtës dhe instrumentat derivativë financiarë

Shoqëria nuk përdor instrumenta financiare mbrojtëse, panvarësisht se është e ekspozuar ndaj riskut financiar.

❖ ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me ligjin Nr.9477 datë 09.02.2006 dhe me SKK 2, Shoqëria ka ndërtuar një plan vetjak të llogarive në përputhje dhe në zbatim të SKK të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Departamenti i Financës përbëhet nga disa specialist finance. Kontabiliteti mbahet në mënyrë të informatizuar nëpërmjet programit të Kontabilitetit "Programi Alpha Platinum".

❖ SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE



RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR
MBI
PASQYRAT FINANCIARE TË SHOQËRISË

“AZ DISTRIBUTION” SHPK

PERIUDHA USHTRIMORE

01.01.2018 – 31.12.2018

BENDIS HUSI
L52222001G
Nr rregj 368 dt 08.01.2019



Z. FATJON MITA!

Ortak i vetëm i shoqërisë "AZ DISTRIBUTION" shpk, Rruga "Nikolla Tupe", Pallati Nr.1, Ap.4, Kati 4, Numër pasurie 31124+1-4, Zona kadastrale Nr.8270, Vol 73, Faqe 203, Tiranë.

I NDERUAR ZOTËRI!

OPINIONI

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "AZ DISTRIBUTION" shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë "AZ DISTRIBUTION" shpk me datën 31 Dhjetor 2018, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).


BAZA PËR OPINIONIN

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Profesionistëve Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (kodi i BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

PËRGJEGJËSITË E DREJTIMIT NË LIDHJE ME PASQYRAT FINANCIARE

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për

Bendis Husi
BENDIS HUSI
L52222001G
Nr rregj 368 dt 08.01.2019



të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE


Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.


Ne do të ushtrojmë gjykimin tonë profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit, në pajtim me SNA-të.

Ne do të identifikojmë dhe të vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, do të hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve si dhe, do të marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontrolleve të brendshme.

Ne do të sigurojmë njohjen dhe kuptimin për kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin, në mënyrë që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion lidhur me efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm të entitetit.

Bendis Husi


BENDIS HUSI
L5222001G
Nr rregj 368 dt 08.01.2019



Ne do të vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e çmuarjeve (vlerësimeve) kontabël dhe informacioneve shpjeguese përkatëse të dhëna nga drejtimi.


Ne do të arrijmë në një konkluzion lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë nga ana e drejtimit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, do të vlerësojmë nëse ekziston një pasiguri materiale lidhur me ngjarje ose rrethana të cilat mund të hedhin një dyshim të madh për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë. Konkluzionet tona do të bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana të ardhshme mund të bëjnë që entiteti të ndalojë së vijuari veprimtarinë.

TIRANË, 11 PRILL 2019

AUDITUES LIGJOR





BENDIS HUSI
L52222001G
Nr rregj 368 dt 08.01.2019



RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR
PERIUDHA 01.01.2017 – 31.12.2017

“AZ DISTRIBUTION“ SHPK

03 MAJ 2018



PËRMBAJTJA


I. RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

II. PASQYRAT FINANCIARE 31.12.2017

- ❖ PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)
- ❖ PASQYRA E PERFORMANCËS (PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE)
- ❖ PASQYRA E FLUKSIT TË MJETVE MONETARE
- ❖ PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO

III. SHËNIME PËR DREJTIMIN E SHOQËRISË

- ❖ TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SHOQËRINË
- ❖ PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL
- ❖ ORGANIZIMI I KONTABILITETIT
- ❖ SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE



**I. RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR
MBI AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË**

"AZ DISTRIBUTION" sh.p.k

DREJTUAR: Z. FATJON MITA!

Ortak i vetëm i shoqërisë "AZ DISTRIBUTION" shpk, Rruga "Nikolla Tupa", Pallati Nr.1, Ap.4, Katë 4, Numër pasurie 31124+1-4, Zona kadastrale Nr.8270, Vol 73, Faqe 203, Tiranë.

Lidhur me shqyrtimin e Pasqyrave Financiare të periudhës janar-dhjetor 2017.

I NDERUAR ZOTËRI!

OPINIONI


Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "**AZ DISTRIBUTION**" shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë "**AZ DISTRIBUTION**" shpk me datën 31 Dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

BAZA PËR OPINIONIN

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Profesionistëve Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (kodi i BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e

GERTA AVRAMI
L51423030F
Nr rregj 348 dt 16.01.2015



auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

PËRGJEGJËSITË E DREJTIMIT NË LIDHJE ME PASQYRAT FINANCIARE

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Ne do të ushtrojmë gjykimin tonë profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit, në pajtim me SNA-të.

Ne do të identifikojmë dhe të vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, do të hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve si dhe, do të marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse




mashtimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontroleve të brendshme. Ne do të sigurojmë njohjen dhe kuptimin për kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin, në mënyrë që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion lidhur me efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm të entitetit.

Ne do të vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e çmuarjeve (vlerësimeve) kontabël dhe informacioneve shpjeguese përkatëse të dhëna nga drejtimi.


Ne do të arrijmë në një konkluzion lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë nga ana e drejtimit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, do të vlerësojmë nëse ekziston një pasiguri materiale lidhur me ngjarje ose rrethana të cilat mund të hedhin një dyshim të madh për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë. Konkluzionet tona do të bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana të ardhshme mund të bëjnë që entiteti të ndalojë së vijuari veprimtarinë.

TIRANË, 03 MAJ 2018

AUDITUES LIGJOR



GERTA AVRAMI
L51423030F
Nr rregj 348 dt 16.01.2015



PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2017

Pasqyra e Pozicionit Financiar

AKTIVET		31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
I	Aktive Afatshkurtra		
1	Mijetet Monetare	8,136,158	3,039,898
2	Investime		
1)	Ne tituj pronesis te njesive ekonomike brenda grupit		
2)	Aksionet e veta		
3)	Te tjera financiare		
	Totali	-	-
3	Te drejta te arketueshme		
a)	Nga aktiviteti i shfrytezimit	213,873,618	47,068,378
b)	Nga njesite ekonomike brenda grupit		
c)	Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrrese		
d)	Te tjera		
e)	Kapital i nenshkruar i papaguar	655,775,286	311,635,096
	Totali	869,648,904	358,703,474
4	Inventari		
a)	Lende e pare dhe materiale te konsumueshme		
b)	Prodhime ne proces dhe gjysenprodukte		
c)	Produkte te gatshme		
d)	Mallra		
e)	Aktive biologjike (Gje e gjalle ne tiritje e majneri)	20,696,298	19,600,961
f)	AAGJM te mbajtura per shitje		
g)	Parapagime per inventar		
	Totali	20,696,298	19,600,961
5	Shpenzime te shtyra	54,172,660	25,998,873
6	Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara	117,400	117,400
	Total i Aktiveve Afatshkurtra	952,771,420	407,460,606
II	Aktive Afatgjata		
1	Aktive Financiare		
a)	Tituj pronesis ne njesite ekonomike brenda grupit		
b)	Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grupit		
c)	Tituj pronesis ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrrese		
d)	Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrrese		
e)	Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjata		
f)	Tituj te tjere te huadhenies		
	Totali	-	349,598,556
2	Aktive Afatgjata Materiale		
a)	Toka dhe ndertesat	507,791,451	488,454,628
b)	Implante dhe makineri	3,300,597	3,200,763
c)	Te tjera instalime dhe pajisje	14,136,336	12,084,739
d)	Mjete transporti	3,461,240	3,461,240
e)	Parapagime per aktive materiale dhe ne proces		
	Totali	528,689,624	507,201,370
3	Aktive Biologjike Afatgjate		
4	Aktive Afatgjata Jomateriale		
a)	Koncesione, licensa, marka tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme	1,048,833	923,833
b)	Emet i Mire		
c)	Parapagime per AAIM		
	Totali	1,048,833	923,833
5	Aktive fatimore teshtyra		
	Totali i Aktiveve Afatgjata	529,738,457	857,723,760
	TOTALI AKTIVEVE	1,482,509,877	1,265,184,366


Keto pasqyra financiare dhe shenimet ne vijim nga faqja 11 deri ne 23, jane aprovuar nga drejtimi i Shoqerise dhe jane nenshkruar ne emer te saj nga,

FATJON MITA

Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

GERTA VERA
L.514230301
Nr rregj 348 dt 16.01.2016



PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2017

Pasqyra e Pozicionit Financiar

PASIVET DHE KAPITALI		31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
I	Detyrimet afatshkurtra		
1	Huamarrjet		
1)	Titujt e huamarrjes		
2)	Detyrimet ndaj institucioneve te kredise	794,552,070	780,948,587
3)	Arketime ne avance per porosi		
4)	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	288,917,191	86,342,622
5)	Deflesa te pagueshme		
6)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit		
7)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemartese		
8)	Te pagueshme ndaj punonjeseve dhe sigurimeve shoqerore/shendetesore	1,826,055	1,912,641
9)	Te pagueshme per detyrimet tatimore	397,324	261,281
10)	Te tjera	5,412,996	4,639,839
	Totali	1,091,105,636	874,104,971
4	Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
5	Te ardhura te shtyra		
6	Provizione		
	Pasive Totale Afatshkurtra	1,091,105,636	874,104,971
II	Detyrime afatgjata		
I	Huate afatgjata		
1)	Titujt e huamarrjes		
2)	Detyrime ndaj institucioneve te kredise		
3)	Arketime ne avance per porosi		
4)	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit		
5)	Deflesa te pagueshme		
6)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit		
7)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemartese		
8)	Te tjera te pagueshme		
	Totali		
2	Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
3	Te ardhura te shtyra		
4	Provizione:		
1)	Provizione per pensionet		
2)	Provizione te tjera		
4	Detyrime tatimore te shtyra		
	Pasive Totale Afatgjata		
	Totali i pasiveve	1,091,105,636	874,104,971
III	Kapitali		
1)	Kapitali i nenshkruar	466,194,300	466,194,300
2)	Primi i lidhur me kapitalin		
3)	Rezerva rivleresimi		
4)	Rezerva te tjera		
a)	Rezerva ligjore		
b)	Rezerva statutare		
c)	Rezerva te tjera		
5)	Fitimi i pashperndare	(75,114,905)	(75,333,062)
6)	Fitimi (humbje) e vitit financiar	324,846	218,157
	Totali i Kapitalit	391,404,241	391,079,395
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT	1,482,509,877	1,265,184,366

Keto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

FATJON MITA



Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

GERTA

L51423030F

Nr regj 348 dt 10.01.2004



PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2017

Pasqyra e Performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE		31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
1	Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	648,562,634	319,765,087
2	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		
3	Puna e kryer nga njesia ekonomike dhe e kapitalizuar		
4	Te ardhura të tjera të shfrytëzimit	93,333	19,440,117
5	Lenda e pare dhe materiale të konsumueshme		
a)	Lenda e pare dhe materiale të konsumueshme	554,789,846	286,814,021
b)	Te tjera shpenzime		
6	Shpenzimet e personelit	28,292,144	24,251,483
a)	Pagat dhe shpërblimet	24,402,577	21,048,477
b)	Shpenzimet e sigurimeve shoqërore/shendetësore	3,889,567	3,203,006
7	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	3,388,919	
8	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	68,002,041	24,952,357
9	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	(5,816,983)	3,187,343
		44,801,798	-
10	Te ardhura të tjera		
a)	Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrëse (paraqitur vecmas të ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)	6,290,879	
b)	Te ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur vecmas të ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)		
c)	Interesa të arketueshem dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur vecmas të ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)	38,510,919	
11	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra		
12	Shpenzime financiare	38,554,249	2,875,186
a)	Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet për t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)	38,510,918	4,174,840
b)	Shpenzime të tjera financiare	43,331	(1,299,654)
		6,247,549	(2,875,186)
13	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		
14	Fitimi/Humbja para fitimit	430,566	312,157
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	105,720	94,000
a)	Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	105,720	94,000
b)	Shpenzimi aktual i tatimit fitimit të shtyre		
c)	Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve		
16	Fitim (humbje) neto e vitit	324,846	218,157
17	Fitim (humbje) për:		
a)	Pronaret e njesise ekonomike me me		
b)	Interesa jo-kontrolluese		


Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

FATJON MITA

Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

GERTA AVRA
L51423030F
Nr rregj 348 dt 16.01.2015



PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2017

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare (Metoda Indirekte)

Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	2017	2016
Fitim / Humbja e vitit	324,846	218,157
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	3,388,919	-
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rritje/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(539,119,217)	183,271,356
Rritje/(rritje) në inventare	(1,095,337)	(5,685,046)
Rritje/(rritje) në detyrimet e pagueshme	203,483,769	(388,120,667)
Rritje/(rritje) në detyrime për punonjësit	(86,586)	591,248
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(333,103,607)	(209,724,952)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve		
Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(21,613,253)	(25,299,773)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera	349,598,556	(349,598,556)
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		
Dividente të arkëtuara		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	324,596,384	(374,898,329)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		466,194,300
Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		
Hua të arkëtuara		
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë	13,603,483	116,605,145
Ritërrje e aksioneve të veta		
Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		
Pagesa e huave		
Pagesa e detyrimeve të qirase financiare		
Interes të paguar		
Dividente të paguar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	13,603,483	582,799,446
Rritje/(rritje) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	5,096,260	(1,823,836)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	3,039,898	4,863,734
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	8,136,158	3,039,898

Keto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

FATJON MIT

Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

GERTA AVRAMI

L51423030F

Nr rregj 348 dt 16.01.2015

"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2017

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rislerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Ju-Kontrollues	Totali
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2016	466,194,300		-	-	-	-	(32,579,804)	(42,753,258)	390,861,238		390,861,238
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											
Fitim / Humbja e vitit								318,157	218,157		218,157
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:											
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:											
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:											
Emetimi i kapitalit të nënshkruar											
Dividende të paguar											
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike							(42,753,258)	42,753,258			
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016	466,194,300		-	-	-	-	(75,333,062)	218,157	391,079,395		391,079,395
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2017	466,194,300		-	-	-	-	(75,333,062)	218,157	391,079,395		391,079,395
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:											
Fitim / Humbja e vitit								324,846	324,846		324,846
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:											
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:											
Emetimi i kapitalit të nënshkruar											
Dividende të paguar											
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike							218,157	(218,157)			
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	466,194,300		-	-	-	-	(75,114,905)	324,846	391,404,241		391,404,241


Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

FATJON MITRO

Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

GERTA AVRAMI
L51423030F
Nr rregj 348 dt 16.01.2015



II. SHËNIME PËR DREJTIMIN E SHOQËRISË

Shoqëria "AZ DISTRIBUTION" shpk, Rruga "Nikolla Tupe", Pallati Nr.1, Ap.4, Kati 4, Numër pasurie 31124+1-4, Zona kadastrale Nr.8270, Vol 73, Faqe 203, Tiranë.

Perindha ushtrimore 01 Janar 2017 deri 31 Dhjetor 2017

❖ TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Shoqëria "AZ DISTRIBUTION" sh.p.k, është regjistruar si shoqëri pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 04 Tetor 2013, me seli në Tiranë me adresë Rruga "Nikolla Tupe", Pallati Nr.1, Ap.4, Kati 4, Numër pasurie 31124+1-4, Zona kadastrale Nr.8270, Vol 73, Faqe 203.

Krijimi i shoqërisë është bazuar në ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 dhe ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993, përkatësisht "Për Shoqëritë Tregtare" dhe "Për Regjistrin Tregtar". Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi. Ajo është e regjistruar në organet tatimore me NIPT L32204031E.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është tregtimi i karburantit të ndryshëm me pakicë, si dhe vajrave lubrifikante, të gazit të lëngshëm për ngrohje, pajisje ngrohëse gazi, si dhe mbushjen e bomblave të gazit dhe tregtimi i tyre me pakicë.

Aktiviteti i shoqërisë është parashikuar të zhvillohet në një afat kohor të papërcaktuar.

✓ Kapitali dhe pronësia


Shoqëria "AZ DISTRIBUTION" shpk, në krijimin e saj ka patur një kapital themeltar 100,000 lekë të ndarë në 100 pjesë me vlerë nominale 1,000 secila.

Shoqëria "AZ DISTRIBUTION" shpk është një shoqëri e përbërë nga një ortak i vetëm Z. Fatjon Mita i cili zotëron nga 100% të pjesëve të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.

Me vendim të asamblesë së ortakëve kapitali i shoqërisë është rritur në 466,194,300 lekë, i ndarë në 1 pjesë me vlerë nominale 466,194,300 lekë/pjesa. Ndryshimet e fundit në kapitalin e nënshkruar janë regjistruar në QKB në datën 20.10.2016

✓ Administrimi

Struktura organike, Administrimi, Organizimi, Drejtimi i përshtaten natyrës së shoqërisë dhe realizimit të objektit të veprimtarisë së saj. Shoqëria drejtohet nga Administratori e cila është Z. Fatjon Mita.



❖ PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL.

✓ Mënyra e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në të gjithë aspektet e tyre materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me ligjin Nr.9477 datë 09.02.2006 për "Standardet Kombëtare të Kontabilitetit" si dhe Urdhërin Nr.64 datë 22.07.2014 për "Shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre" të miratuara me urdhër të Ministrit të Financave.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke zbatuar Politikat Kryesore Kontabël:

Politika për njohjen e aktiveve, për njohjen e detyrimeve, njohjen e të drejtave, njohjen e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe vlerësimin e tyre.

Gjatë përgatitjes së Pasqyrave Financiare janë mbajtur parasysh Parimet Bazë të Kontabilitetit si: Parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, Parimi i njësisë ekonomike raportuese, Parimi i vijimësisë si dhe Parimi i kompensimit. Karakteristikat cilësore të përgatitjes së Pasqyrave Financiare të cilat e bëjnë informacionin të dobishëm për përdoruesit dhe që janë përdorur gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare janë: Kuptueshmëria, Rëndësia dhe Materialiteti, Besueshmëria, Parimi i përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formen ligjore, Paanshmëria, Plotësia, Maturia, Qëndrueshmëria dhe Krahueshmëria.

Pasqyrat Financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e Kostos Historike.

Pasqyrat Financiare janë shprehur në monedhën vendase LEKË.

Deklarata e përpunshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Përmirësuara të Kontabilitetit të cilat janë hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit të Rrepublicës së Shqipërisë dhe të shpallura nga Ministri i Financave.

Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në metodën e kostos historike.

Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur në Lekë, e cila është monedha funksionale për shoqërinë.

Humbje nga rënia në vlerë e aktiveve

Shoqëria teston vlerën e aktiveve të saj financiare rregullisht për të konstatuar rënie të mundshme vlere. Për të përcaktuar nëse një rënie e mundshme vlere duhet njohur në pasqyrën e të ardhurave, Shoqëria gjykon nëse ka ndonjë të dhënë të dallueshme që të ketë një rënie të matshme në flukset monetare të pritshme nga portofoli i aktiveve financiare, përpara se ulja të identifikohet e ekspozuar individualisht në portofol.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të dallueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim jo të favorshëm në gjendjen e pagesave të klientëve në Shoqëri, apo në gjëndjen ekonomike kombëtare apo lokale që lidhet me mospagesat në aktivet e Shoqërisë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivet financiare dhe detyrimet për të cilat nuk ka një çmim tregu të dallueshëm, kërkohej përdorimi i teknikave vlerësuese siç përshkruhet në shënimin 4 në pasqyrat financiare.

Përlllogaritja e tatim fitimit

Drejtimi beson se përlllogaritja e kujdesshme e tatimit mbi fitimin duke pasur parasysh ambientin fiskal shqiptar dhe legjislacionin ekzistues në fuqi si dhe rezultatet e mundshme të edo inspektimi tatimor, nuk do të ketë ndikim sinjifikativ në pozicionin financiar, rezultatën operativ apo flukset monetare të Shoqërisë.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK, kërkon që drejtimi i shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre çmuarjeve.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në vecanti, informacion mbi elemente të rëndësishme në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare përshkruhen në paragrafët më poshtë.

✓ Rregullat për vlerësimin e Mjeteve Monetare

Mjetet Monetare përfaqsojnë likuiditetet e njësisë ekonomike në Arkë dhe në Bankë, në llogari rrjedhëse, investime në tregun e parës dhe tregje të tjera shumë likuide duke ndjekur politikën e Vlerës së Drejtë në zbatim të SKK 3.

(a) Veprimet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetare është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave, përveç diferencave që rrjedhin nga konvertimi i instrumentëve të kapitalit të vlefshme për shitje (nëse ka).

Kurset e këmbimit më të rëndësishme janë :

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2017
Euro	135.23	132.95
Usd	128.17	111.10

(b) Instrumenta financiare

Instrumentë financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përfshijnë llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, dhe llogari të pagueshme. Gjatë periudhave të raportimit shoqëria nuk ka investime në letra me vlerë. Instrumentët financiarë jo-derivativë janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumentëve financiarë joderivativë përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet në rast se Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktiviteti financiar përfundojnë, ose të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të një aktiviteti financiar janë regjistruar në datën e tregtimit, psh datën në të cilën Shoqëria zotohet të blejë ose të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

(c) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në banka. Për qëllime të fluksit të mjeteve monetare, këtu përfshihen edhe depozitat në formën e garancisë për huatë me maturitet më shumë se 3 muaj ose më pak nga data origjinale.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Aktiveve të tjera financiare afatshkurtra**

Aktive të tjera financiare afatshkurtra, kërkesa të arkëtueshme afatshkurtra, letra me vlerë dhe investime të tjera financiare janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale të lëshuara apo dokumentëve të tjerë kontabël. Politika kontabël e ndjekur për aktivet financiare afatshkurtra është sipas koston së amortizuar (vlerë nominale të kërkesës për arkëtim minus zhvlerësim nëse ka) sipas SKK 3. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave dhe dokumentëve origjinalë kontabël. Llogaritë e aktiveve të tjera financiare afatshkurtra në monedhë të huaj, në datën e mbylljes së bilancit janë vlerësuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2017. Diferencat respektive janë të reflektuara në llogaritë e rezultatit.


✓ **Rregullat për vlerësimin e Gjendjeve të Inventarit**

Gjendjet e Inventarit të shoqërisë përbëhen nga Mallrat për rishitje të cilat vlerësohen me vlerën më të vogël të koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përfshin materialet direkte dhe punën direkte kur është e aplikueshme dhe koston e tjera që janë shpenzuar për të sjellë inventarët në gjendjen dhe vendin aktual. Vlera neto e realizuar tregon vlerën e çmuar të çmimit të shitjes në aktivitetin e biznesit, duke i zbritur koston e çmuar të marketingut, shitjes dhe shpërndarjes. Kostoja e inventareve të tjerë është bazuar në parimin FIFO (e hyra e parë e dala e parë) dhe përfshin shpenzimet e përdorura në përvetësimin e inventarit dhe për të sjellë ato në kushtet dhe vendin e tyre ekzistues. Shuma e përshtatshme për zhvlerësim njihet në pasqyrën e të ardhurave kur ka një evidencë objektive që aktivi është zhvlerësuar. Kosto e inventarit është llogaritur për çdo zë duke përdorur metodën FIFO në zbatim të SKK 4. Në të përfshihen shpenzimet e blerjes së mallrave, shpenzimet e transportit, shpenzimet në doganë, shpenzimet e ngarkim-shkarkimit si dhe çdo shpenzim tjetër i bërë deri në magazinimin e mallrave.

✓ **Rregulla për vlerësimin e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra përfaqsojnë shpenzimet e bëra gjatë vitit financiar por që u përkasin periudhave të ardhshme të njësisë ekonomike. Për to është ndjekur politika kontabël kosto minus zhvlerësim nëse ka, pasqyruar sipas përcaktimit të zbatim të SKK 1.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Aktiveve Afatgjata**



Aktivitet afatgjata material dhe jomateriale pasqyrohen në bilanc me vlerën e tyre neto.

Aktivitet Afatgjatë jomaterialë sipas SKK 5 janë përfshirë në Pasqyrat Financiare duke ndjekur politikën kontabël Kosto e blerjes ose prodhimit ose shumën e rivlerësuar minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin nëse ka.

Aktivitet Afatgjatë materialë sipas SKK 5 janë përfshirë në Pasqyrat Financiare duke ndjekur politikën kontabël Kosto e blerjes ose prodhimit ose shumën e rivlerësuar minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin nëse ka. Metoda e llogaritjes së amortizimit bëhet në zbatim të ligjit Nr.8438 datë 28.12.2008 "Për Tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. Baza e llogaritjes së amortizimit bëhet mbi Vlerën Neto Kontabël. Llogaritja e amortizimit për aktivet e hyra gjatë vitit është bërë duke filluar nga data 1 e muajit pasardhës.

1. Njohja dhe matja


Zërat e aktiveve afatgjata materialë paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih me poshte) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, (nëse ka).

Ë gjithë pasuria e paluajtshme, ndërtesat dhe makineritë paraqiten në kosto, historike (sic pershkruhet në paragrafin e mëposhtëm) minus amortizimin përkatës dhe zhvlerësimin, përveç për tokën, e cila pasqyrohet me koston historike minus zhvlerësimin. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve, punës direkte, si dhe çdo kosto tjetër që lidhet me sjelljen e këtyre aktiveve në gjëndje pune dhe kostot për çmontimin dhe lëvizjen e tyre dhe përgatitjen e vendit në të cilin do të vendosen. Programet kompjuterike të blera që janë të nevojshme për vendosjen në funksion të këtyre aktiveve të cilat kapitalizohen si pjesë të këtyre makinerive. Aktivitet të cilat janë nxjerrë jashtë përdorimit kanë qenë të kontabilizuar me vlerën e bazuar në vlerën e tyre neto në datën e daljes jashtë përdorimit. Kostot e pjesëve të ndërrimit për makineritë dhe pajisjet njihen me vlerën e tyre kontabël nëse është e mundur që njësia ekonomike të përfitojë të ardhura ekonomike nga kjo pjesë dhe këto të ardhura mund të maten në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes dhe riparimeve të përditshme të pasurive të paluajtshme, makinerive dhe pajisjeve njihen në fitim e humbje kur ato ndodhin.

2. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare mbi vlerën e mbetur kontabël në mënyrë që, kosto e çdo aktivi deri në vlerën e mbetur, të shpërndahet përgjatë të gjithë jetës së tij të dobishme si me poshte:

Ndërtesat	5 %
Instalime teknike, makineri e pajisje	20%



Mjete transporti	20%
Mobilje dhe orendi	20%
Pajisje zyre dhe informatike	25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nëse nuk është e pakonsiderueshme) të aktiveve materiale afatgjatë janë rishikuar në datën e raportimit. Toka dhe Ndërtimet në Proçes, si dhe parapagimet furnitorëve nuk amortizohen.

Pfitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen nga krahasimi i përfitimeve me vlerën e tyre kontabël. Këto përfshihen në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

3. *Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuhen atij elementi do ti rrjedhin Shoqërisë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmeri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.


4. *Aktivet e marra me qera*

Aktivet e marra me qira janë të klasifikuara si qira financiare kur termat e transferimit të risqeve dhe pronësisë kalojnë te qiramarresi, Të gjitha qeratë e tjera janë të klasifikuara si qera operative. Asetet që janë rregjistruar si qera financiare rregjistrohen si asete të Shoqërisë me vlerën e drejtë në datën e fillimit të qerasë, ose me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qerasë nëse kjo e fundit është më e vogël. Pagesat e qerasë regjistrohen si shpenzime financiare dhe zvogëlimit të detyrimit të qerasë që të arrijë një normë konstante të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimit.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Huamarrjeve Afatshkurtra**

Në huamarrjet afatshkurtra përfshihen huatë (deri në 12 muaj) për financime afatshkurtra si dhe pjesa e huave dhe detyrimeve të qerasë financiare që do të paguhet Brenda 12 muajve të ardhshëm të klasifikuara sipas SKK 3 dhe SKK 7 duke ndjekur politikën kontabël të koston së amortizuar. Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të pakësuar për humbjet për zhvlerësime.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Huave dhe Parapagimeve**



Huatë dhe parapagimet janë vlerësuar sipas faturave të blerjes dhe dokumentëve të tjerë origjinalë kontabël. Politika kontabël e ndjekur është në bazë të kostos së amortizuar në zbatim të SKK 3.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Huamarrjeve Afatgjata**

Në huamarrjet afatgjata përfshihen huatë (mbi 12 muaj) për financime afatgjata si dhe pjesa e huave dhe detyrimeve të qerasë financiare që do të paguhen pas 12 muajve të ardhshëm të klasifikuara sipas SKK 3 dhe SKK 7 duke ndjekur politikën kontabël të kostos së amortizuar.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Kapitalit**

Kapitali i shoqërisë vlerësohet sipas vlerës kontabël të kapitalit aksionar të emetuar në krijim të saj, rezervave të krijuara në përputhje me statutin si dhe në përputhje me ligjin "Për Shoqëritë Tregtare" ose ndonjë ligj tjetër të aplikueshëm, fitimeve të pashpërndara që përbëjnë fitimet e akumuluar në vite si dhe fitimi ose humbja e vitit financiar që përbëhet nga fitimi ose humbja në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

✓ **Rregullat e vlerësimit të të Ardhurave**

Të ardhurat përfaqsojnë shitjet neto e rrjedhimisht të ardhurat e përfituara nga shitja e mallrave dhe produkteve, shërbimeve gjatë periudhës kontabël të vlerësuara sipas SKK 8. Ato regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe të lidhjes që kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, panvarësisht se arkëtimi i tyre ose i një pjese prej tyre do të ndodhë në vitin ushtrimor pasardhës. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose për tu arkëtuar dhe përfaqson vlerën e arkëtueshme përtë mirat dhe shërbimet e siguruara gjatë aktivitetit normal të shoqërisë, neto nga zbritjet dhe shitjet të lidhura me taksën. Shitjet e mallrave njihen kur mallrat janë dërguar dhe gjithashtu kanë kaluar dhe pronësinë e tyre. E ardhura nga shërbimet e kryera njihet në pasqyrën e të ardhurave në përpjestim me volumin e shërbimit të kryer në datën e bilancit. Vlerësimi i volumit të shërbimit bëhet duke iu referuarurvejimeve të punës së kryer.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Shpenzimeve Direkte**

Shpenzimet e njësisë ekonomike të vitit financiar përfaqsojnë shpenzimet e blerjes së mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara për veprimtarinë parësore, koston e shërbimeve kryesore të vlerësuara me çmimin e blerjes e të vërtetuara me fatura origjinale e dokumentë të tjerë kontabël, shpenzime që lidhen në mënyrë direkte me mallrat ose produktet e destinuara për shitje. Pagat, shpërblimet dhe kompensimet monetare, sigurimet shoqërore të paguara nga shoqëria të llogaritura mbi pagat që i përkasin periudhës kontabël panvarësisht nëse ato janë

paguar ose jo. Shpenzimet për amortizimin që vijnë nga rënia në vlerë e aktiveve afatgjata. Shpenzimet e tjera që janë shpenzimet e papërfshira në zërat e mësipërm por që lidhen me veprimtarinë kryesore të njësisë ekonomike.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Shpenzimeve të Qerasë**

Pagesat e bëra për qeratë operationale njihen në fitim ose humbje me mënyrën lineare gjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së marrë njihen si një pjesë integrale e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë periudhës së qirasë. Minimumi i pagesave të qerasë të bëra nën qeratë financiare janë shpërndarë midis shpenzimeve financiare dhe pakësimit të detyrimit të mbetur. Shpenzimi financiar është shpërndarë në çdo periudhë të termave të qerasë për të krijuar një normë interesi konstante periodike mbi tepricën e mbetur të detyrimit.


✓ **Rregullat e vlerësimit të shpenzimeve (të ardhurave) Financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave. Të ardhurat nga interesi njihen dhe përlllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Të gjitha kostot e huave njihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën e interesit efektiv.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Tatimit mbi Fitimin**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në keto raste tatim fitimi njihet si zë i kapitalit. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet në normën e tatimit që pritet të aplikohet në diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin tatimor që janë ose hyjnë në fuqi në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për atë sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditimet tatimore të papërdorura. Aktivi tatimor i shtyrë zvogëlohet për atë sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Fondit të Pensioneve**



Shoqëria paguan kontribute për pensione si dhe kontribute për sigurim shëndetsor për punonjësit e saj siq është parashikuar nga legjislacioni vendas. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtarë përgjegjës për pagesën e pensioneve dhe shërbimeve shëndetsore.

Sigurime shoqërore të detyrueshme

Shoqëria, në rrjedhen normale të biznesit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin lokal. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

Leje vjetore të paguara

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhen në këmbim për shërbimin e punonjësve për gjatë periudhës.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Provizioneve**

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si një rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhjë e burimeve duke personifikuar fitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të rregulluar detyrimin dhe një vlerësim të besueshëm të vlerës së detyrimit që mund të bëhet. Nëse efekti është material, provizionet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parashit, dhe kur është e nevojshme riskun specifik të detyrimit. Provizionet paraqiten në çdo datë bilanci dhe nëse nuk është akoma e mundur që rrjedhja e burimeve duke personifikuar burime ekonomike të përdoret për rregullimet e detyrimeve, provizionet anulohen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje shfrytëzuese të ardhme. Aktivët dhe detyrimet e rastit nuk njihen.

✓ **Rregullat e Menaxhimit të Riskut Financiar**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumentave financiarë:

- Risku i kredisë
- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut

Menaxhimi mbart përgjegjësinë për vendosjen dhe mbikqyrjen e politikave të shoqërisë për menaxhimin e riskut. Këto politika duhet të rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e shoqërisë. Instrumentat financiarë kryesorë të shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në bankë, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme si dhe detyrime të tjera afatshkurtra.

Risku i kredisë

Në varësi të volumit të llogarive të arkëtueshme përcaktohet dhe risku i kredisë. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme mbahet në shumën e konsideruar të nevojshme për të mbuluar riskun potencial në mbledhjen e tepricave të llogarive të arkëtueshme.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj lidhur me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është i qënësishëm në shoqëri dhe menaxhohet duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet për flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Risku i tregut

Përbëhet nga risku i normave të interest dhe risku i kursit të këmbimit.

Risku i normave të interesit

Shoqëria përballlet me riskun e normës së interest të flukseve të parasë në lidhje me hua dhe overdraft që ajo merr me normë variabël.

Risku i kursit të këmbimit

Llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme në monedhë të huaj apo huate janë faktorë që e ekspozojnë shoqërinë ndaj riskut të kursit të këmbimit.

Analiza e ndjeshmërisë

Duke administruar riskun e normave të interest dhe të pozicionit valuator, shoqëria mund të reduktojë ndikimet e luateve afatshkurtra në fitimet e saj. Në periudha afatgjata sidoqoftë menaxhimi i këtyre risqeve mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në fitim.

Administrimi i Kapitalit

Politikat e shoqërisë janë të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit.

Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse evidenca objektive zhvlerësimi tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivit financiar.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të vlefshëm për shitje është llogaritur kundrejt vlerës së tij të drejtë. Aktivet financiare të cilat janë të konsiderueshme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet së bashku në grupe që mbartin karakteristika të ngjashme risku. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Ndonjë humbje kumulative në lidhje me aktivet financiare të vlefshme për shitje të njohura me parë në letra me vlerë transferohet tek humbje fitimi. Një humbje nga zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Anullimi njihet në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga zhvlerësimi në periudhat e mëparshme janë rishikuar në çdo datë raportimi për rastet kur humbja rritet ose nuk ekziston më. Një humbje zhvlerësimi anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për caktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.


Kontabiliteti mbrojtës dhe instrumentat derivativë financiarë

Shoqëria nuk përdor instrumenta financiare mbrojtëse, panvarësisht se është e ekspozuar ndaj riskut financiar.

❖ **ORGANIZIMI I KONTABILITETIT**

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me ligjin Nr.9477 datë 09.02.2006 dhe me SKK 2. Shoqëria ka ndërtuar një plan vetjak të llogarive në përputhje dhe në zbatim të SKK të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Departamenti i Financës përbëhet nga disa specialist finance. Kontabiliteti mbahet në mënyrë të informatizuar nëpërmjet programit të Kontabilitetit "Programi Alpha Platinum".

❖ **SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**



RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR
PERIUDHA 01.01.2019 – 31.12.2019

“AZ DISTRIBUTION” SHPK



20 MAJ 2020

AUDITUES LIGJOR
BENDIS HUSI



"AZ DISTRIBUTION" SHIPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PËRMBAJTJA

I. RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

II. PASQYRAT FINANCIARE 31.12.2019


- ❖ PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)
- ❖ PASQYRA E PERFORMANCËS (PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE)
- ❖ PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE
- ❖ PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO



III. SHËNIME PËR DREJTIMIN E SHOQËRISË

- ❖ TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SHOQËRINË
- ❖ PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL
- ❖ ORGANIZIMI I KONTABILITETIT
- ❖ SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR



**I. RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR
MBI AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË**

"AZ DISTRIBUTION" sh.p.k

DREJTUAR: Z. FATJON MITA!

Ortak i vetëm i shoqërisë "AZ DISTRIBUTION" shpk, Bulevardi Dëshmoret e Kombit, Kallit Binjake, kulla Nr.1, Katë 13, Tiranë.

Lidhur me shqyrtimin e Pasqyrave Financiare të periudhës janar-dhjetor 2019.

INDERUAR ZOTËRI!

OPINIONI

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "AZ DISTRIBUTION" shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë "AZ DISTRIBUTION" shpk me datën 31 Dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

BAZA PËR OPINIONIN

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Profesionistëve Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (kodi i BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e



"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

PËRGJEGJËSITË E DREJTIMIT NË LIDHJE ME PASQYRAT FINANCIARE

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë

PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Ne do të ushtrojmë gjykimin tonë profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit, në pajtim me SNA-të.

Ne do të identifikojmë dhe të vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, do të hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve si dhe, do të marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse

Bendis Hushi
BENDIS HUSHI
L5222001G

Në shtet: 368-41 09 01 01010

"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR



mashtimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontrolleve të brendshme. Ne do të sigurojmë njohjen dhe kuptimin për kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin, në mënyrë që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion lidhur me efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm të entitetit.

Ne do të vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e çmuarjeve (vlerësimeve) kontabël dhe informacioneve shpjeguese përkatëse të dhëna nga drejtimi.

Ne do të arrijmë në një konkluzion lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë nga ana e drejtimit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, do të vlerësojmë nëse ekziston një pasiguri materiale lidhur me ngjarje ose rrethana të cilat mund të hedhin dyshim të madh për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë. Konkluzionet tona do të bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana të ardhshme mund të bëjnë që entiteti të ndalojë së vijuari veprimtarinë.

TIRANË, 20 MAJ 2020

AUDITUES LIGJOR



BENDIS HUSI
L5222001G

Nr. 00001 368, 10.08.2010



PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2019

Pasqyra e Pozicionit Financiar

AKTIVET		31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
I	Aktive Afatshkurtra		
1	Mjetet Monetare	3,481,064	6,887,798
2	Investime		
1)	Ne tituj proniesie te njesive ekonomike brenda grupit		
2)	Aksionet e veta		
3)	Te tjera financiare		
	Totali	3,481,064	6,887,798
3	Te drejta te arketueshme		
a)	Nga aktiviteti i shfrytezimit	660,516,533	433,209,914
b)	Nga njesite ekonomike brenda grupit		
c)	Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese		
d)	Te tjera	487,610	1,844,021
e)	Kapital i nenshkruar i papaguar		
	Totali	661,004,143	435,053,935
4	Inventari		
a)	Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	-	-
b)	Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte	-	-
c)	Produkte te gatshme	-	-
d)	Mallra	18,433,358	25,630,889
e)	Aktive biologjike (Gje e gjalle ne rritje e majmeri)		
f)	AAGJM te mbajtura per shitje		
g)	Parapagime per inventar	0	3,918,718
	Totali	18,433,358	29,549,607
5	Shpenzime te shtyra	50,340,436	117,400
6	Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara		
	Total i Aktiveve Afatshkurtra	733,259,001	471,608,740
II	Aktive Afatgjata		
1	Aktive financiare		
a)	Tituj proniesie ne njesite ekonomike brenda grupit		
b)	Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grupit		
c)	Tituj proniesie ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese		
d)	Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese		
e)	Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjata		
	Totali	0	281,130,960
	Totali	0	281,130,960
2	Aktive Afatgjata Materiale		
a)	Toka dhe ndertesa	536,900,896	540,533,496
b)	Implante dhe makineri	9,375,597	4,500,597
c)	Te tjera instalime dhe pajisje	156,249,981	134,588,821
d)	Mjete transporti	3,461,240	3,461,240
	Totali	705,987,713	683,084,154
3	Aktive Biologjike Afatgjate		
4	Aktive Afatgjata Jomateriale		
a)	Koncesione, licensa, marka tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme	1,048,833	1,048,833
b)	Emer i Mire		
c)	Parapagime per AAJM		
	Totali	1,048,833	1,048,833
5	Aktive tatimore teshtyra		
	Totali i Aktiveve Afatgjata	707,036,547	965,263,947
	TOTALI AKTIVEVE	1,440,295,548	1,436,872,687

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

FATJON MITA


Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

BENDIS HUSI

L5222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019



PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2019

Pasqyra e Pozicionit Financiar

PASIVET DHE KAPITALI		31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
I	Detyrimet afatshkurtra		
1	Huamarrjet		
1)	Titujt e huamarrjes		
2)	Detyrimet ndaj institucioneve te kredise	0	150,536,254
3)	Arketime ne avance per porosi		
4)	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit		
5)	Deftesa te pagueshme	343,395,715	216,094,865
6)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit		
7)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemarrtese		
8)	Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetesore	1,054,956	1,300,761
9)	Te pagueshme per detyrimet tatimore	436,568	167,181
10)	Te tjera	231,282	
	Totali	345,118,521	368,099,061
4	Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
5	Te ardhura te shtyra		
6	Provizione		
	Passive Totale Afatshkurtra	345,118,521	368,099,061
II	Detyrime afatgjata		
1	Huate afatgjata		
1)	Titujt e huamarrjes		
2)	Detyrime ndaj institucioneve te kredise		
3)	Arketimet ne avance per porosi	706,906,676	680,724,774
4)	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit		
5)	Deftesa te pagueshme		
6)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit		
7)	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemarrtese		
8)	Te tjera te pagueshme		
	Totali	706,906,676	680,724,774
2	Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
3	Te ardhura te shtyra		
4	Provizione:		
1)	Provizione per pensionet		
2)	Provizione te tjera		
4	Detyrime tatimore te shtyra		
	Passive Totale Afatgjata	706,906,676	680,724,774
	Totali i pasiveve	1,052,025,197	1,048,823,835
III	Kapitali		
1)	Kapitali i nenshkruar		
2)	Primi i lidhur me kapitalin	466,194,300	466,194,300
3)	Rezerva rivleresimi		
4)	Rezerva te tjera		
a)	Rezerva ligjore		
b)	Rezerva statutore		
c)	Rezerva te tjera		
5)	Fitimi i pashperndare	(78,145,448)	(74,790,059)
6)	Fitimi (humbje) e vitit financiar	221,499	(3,355,389)
	Totali i Kapitalit	388,270,350	388,048,852
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT	1,440,295,548	1,436,872,687

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

FATJON MITA

Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019



PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2019

Pasqyra e Performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE		31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	698,562,072	675,684,082
2	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		
3	Puna e kryer nga njesia ekonomike dhe e kapitalizuar		
4	Te ardhura të tjera të shfrytëzimit	18,112,880	1,772,217
5	Lenda e pare dhe materiale të konsumueshme		
a)	Lenda e pare dhe materiale të konsumueshme	609,716,755	586,685,824
b)	Te tjera shpenzime		
6	Shpenzimet e personelit	34,402,325	32,185,794
a)	Pagat dhe shpërblimet	29,595,539	27,713,258
b)	Shpenzimet e sigurimeve shoqërore/shendetësore	4,806,786	4,472,536
7	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	272	707
8	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	59,765,496	69,096,086
9	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	12,790,104	(10,512,112)
		18,224,383	0
10	Te ardhura të tjera		0
a)	Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur vecmas të ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)		
b)	Te ardhura nga investimet dhe huatë të tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur vecmas të ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)		
c)	Interesa të arketueshme dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur vecmas të ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)	18,224,383	
11	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra		
12	Shpenzime financiare	(30,705,129)	7,214,423
a)	Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet për t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)		
b)	Shpenzime të tjera financiare	(30,705,129)	7,214,423
		309,358	(3,297,689)
13	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		
14	Fitimi/Humbja para tatimit	309,358	(3,297,689)
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin		
a)	Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	(87,859)	(57,700)
b)	Shpenzimi aktual i tatimit fitimit të shtyre	(87,859)	(57,700)
c)	Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve		
16	Fitim (humbje) neto e vitit	221,499	(3,355,389)
17	Fitim (humbje) për:		
a)	Pronaret e njesise ekonomike meme		
b)	Interesa jo-kontrolluese		

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

FATJON MITA

Administrator


Hartues i pasqyrave financiare

BENDIS HUSI

L5222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR



PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2019

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare (Metoda Indirekte)

Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	2019	2018
Fitim / Humbja e vitit	221,499	(3,355,389)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	(272)	(707)
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(276,173,245)	488,767,629
Rritje/(rënie) në inventarë	11,116,249	(8,853,309)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	127,801,519	(78,465,465)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(245,805)	(525,294)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(137,280,054)	397,567,465
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve		
Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(22,903,288)	(435,525,490)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		
Dividentë të arkëtuara		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(22,903,288)	(435,525,490)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	156,776,608	36,708,958
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		
Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		
Hua të arkëtuara		
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë		680,724,774
Riblerje e aksioneve të veta		
Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		
Pagesa e huave	156,776,608	(644,015,816)
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		
Interes i paguar		
Dividendë të paguar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	156,776,608	36,708,958
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(3,406,734)	(1,248,360)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	6,887,798	8,136,158
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	3,481,064	6,887,798

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

FATJON MITA

Administrator


Hartues i pasqyrave financiare

BENDIS HUSI

L5222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR



PASQYRAT FINANCIARE 31 Dhjetor 2019
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2018	100,000	466,094,300	-	-	-	-	(75,114,905)	324,846	391,404,203	-	391,404,203
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Fitimi / Humbja e vitit								(3,355,389)	(3,355,389)		(3,355,389)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:									-		-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									-		-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar									-		-
Dividendë të paguar									-		-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									-		-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100,000	466,094,300	-	-	-	-	(75,114,905)	(3,030,543)	388,048,852	-	388,048,852
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2019	100,000	466,094,300	-	-	-	-	(75,114,905)	(3,030,543)	388,048,852	-	388,048,852
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Fitimi / Humbja e vitit								221,499	221,499		221,499
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:									-		-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									-		-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar									-		-
Dividendë të paguar									-		-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									-		-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	100,000	466,094,300	-	-	-	-	(75,114,905)	(2,809,044)	388,270,351	-	388,270,351

Këto pasqyra financiare dhe shënimet në vijim nga faqja 11 deri në 23, janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë dhe janë nënshkruar në emër të saj nga,

FATJON MITA


Administrator

Hartues i pasqyrave financiare

BENDIS HUSI

L52222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019



II. SHËNIME PËR DREJTIMIN E SHOQËRISË

Shoqëria "AZ DISTRIBUTION" shpk, Bulevardi Dëshmoret e Kombit, Kullat Binjake, kulla Nr.1, Kati 13, Tiranë.

Periodha ushtrimore 01 Janar 2019 deri 31 Dhjetor 2019

❖ TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Shoqëria "AZ DISTRIBUTION" shpk, është regjistruar si shoqëri pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 04 Tetor 2013, me seli në Tiranë me adresë Bulevardi Dëshmoret e Kombit, Kullat Binjake, kulla Nr.1, Kati 13.

Krijimi i shoqërisë është bazuar në ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 dhe ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993, përkatësisht "Për Shoqëritë Tregtare" dhe "Për Regjistrin Tregtar". Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi. Ajo është e regjistruar në organet tatimore me NIP L32204031E.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është tregtimi i karburantit të ndryshëm me pakicë, si dhe vajrave lubrifikante, të gazit të lëngshëm për ngrohje, pajisje ngrohëse gazi, si dhe mbushjen e bombave të gazit dhe tregtimi i tyre me pakicë.

Aktiviteti i shoqërisë është parashikuar të zhvillohet në një afat kohor të papërcaktuar.

✓ Kapitali dhe pronësia

Shoqëria "AZ DISTRIBUTION" shpk, në krijimin e saj ka patur një kapital themeltar 100,000 lekë të ndarë në 100 pjesë me vlerë nominale 1,000 secila.

Shoqëria "AZ DISTRIBUTION" shpk është një shoqëri e përbërë nga një ortak i vetëm Z. Fatjon Mita i cili zotëron nga 100% të pjesëve të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.

Me vendim të asamblesë së ortakëve kapitali i shoqërisë është rritur në 466,194,300 lekë, ndarë në 1 pjesë me vlerë nominale 466,194,300 lekë/pjesa. Ndryshimet e fundit në kapitalin e nënshkruar janë regjistruar në QKB në datën 20.10.2017.

✓ Administrimi

Struktura organike, Administrimi, Organizimi, Drejtimi i përshtaten natyrës së shoqërisë dhe realizimit të objektit të veprimtarisë së saj. Shoqëria drejtohet nga Administratori e cila është Z. Fatjon Mita.



"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUEST I LIGJOR

❖ PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL.

✓ Mënyra e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në të gjithë aspektet e tyre materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" e ndryshuar me ligjin Nr.9477 datë 09.02.2006 për "Standardet Kombëtare të Kontabilitetit" si dhe Urdhërin Nr.64 datë 22.07.2014 për "Shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre" të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke zbatuar Politikat Kryesore Kontabël:

Politika për njohjen e aktiveve, për njohjen e detyrimeve, njohjen e të drejtave, njohjen e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe vlerësimin e tyre.

Gjatë përgatitjes së Pasqyrave Financiare janë mbajtur parasysh Parimet Bazë të Kontabilitetit si: Parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, Parimi i njësisë ekonomike raportuese, Parimi i vijimësisë si dhe Parimi i kompensimit. Karakteristikat cilësore të përgatitjes së Pasqyrave Financiare të cilat e bëjnë informacionin të dobishëm për përdoruesit dhe që janë përdorur gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare janë: Kuptueshmëria, Rëndësia dhe Materialiteti, Besueshmëria, Parimi i përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore, Pavarshmëria, Plotësia, Maturia, Qëndrueshmëria dhe Krahueshmëria.

Pasqyrat Financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e Kostos Historike.

Pasqyrat Financiare janë shprehur në monedhën vendase LEKË.

Deklarata e përpuethshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Përmirësuara të Kontabilitetit të cilat janë hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit të Republikës së Shqipërisë dhe të shpallura nga Ministri i Financave.

Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në metodën e kostos historike.


Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur në Lekë, e cila është monedha funksionale për shoqërinë

BENDISHTI SI

L5222001G

Nr regj 368 dt 08.01.2019



Humbje nga rënia në vlerë e aktiveve

Shoqëria teston vlerën e aktiveve të saj financiare rregullisht për të konstatuar rënie të mundshme vlerë. Për të përcaktuar nëse një rënie e mundshme vlerë duhet njohur në pasqyrën e të ardhurave, Shoqëria gjykon nëse ka ndonjë të dhënë të dallueshme që të ketë një rënie të mundshme në flukset monetare të pritshme nga portofoli i aktiveve financiare, përpara se një rënie të identifikohet e ekspozuar individualisht në portofol.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të dallueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim për të favorshëm në gjendjen e pagesave të klientëve në Shoqëri, apo në gjendjen ekonomike kombëtare apo lokale që lidhet me mospagesat në aktivet e Shoqërisë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivet financiare dhe detyrimet për të cilat nuk ka një treg të dallueshëm, kërkohej përdorimi i teknikave vlerësuese siç përkrahët në shënimin 1 të pasqyrat financiare.

Përlogaritja e tatimit fitimit

Drejtimi beson se përlogaritja e kujdesshme e tatimit mbi fitimin duke pasur parasysh ambientin fiskal shqiptar dhe legjislacionin ekzistues në fuqi si dhe rezultatet e mundshme të çdo inspektimi tatimor, nuk do të ketë ndikim sinjifikativ në pozicionin financiar, rezultatit operativ, apo flukset monetare të Shoqërisë.


Përdorimi i vlerësimeve dhe gjyqimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK, kërkon që drejtimi i shoqërisë të kryejë gjyqime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre çmuarjeve.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në vecanti, informacion mbi elemente të rëndësishme në vlerësimin e pasqyrave dhe gjyqime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare përkrahën në paragrafët më poshtë.

✓ Rregullat për vlerësimin e Mjeteve Monetare

Mjetet Monetare përfaqsojnë likuiditetet e njësisë ekonomike në Arkë dhe në Bankë, në Hlogur rrjedhëse, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide duke ndjekur politikën e Vlerës së Drejtë në zbatim të SKK 3.



(a) *Veprimet në monedhë të huaj*

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetare është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave, përveç diferencave që rrjedhin nga konvertimi i instrumentëve të kapitalit të vlefshëm për shifra (nëse ka).

Kurset e këmbimit më të rëndësishme janë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2019
Euro	123.42	121.77
Usd	107.82	108.64

(b) *Instrumenta financiare*

Instrumentë financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përfshijnë llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, dhe llogari të pagueshme. Gjatë periudhës të raportimit shoqëria nuk ka investime në letra me vlerë. Instrumentët financiarë jo-derivativë janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përveçësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumentëve financiarë joderivativë përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet në rast se Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivët financiarë përfundojnë, ose të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivit financiar janë regjistruar në datën e tregtimit, p.sh. datën në të cilën Shoqëria zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

(c) *Mjete monetare dhe ekuivalente me to*

Mjete monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogaritë rrjedhëse në banka.



Për qëllime të fluksit të mjeteve monetare, këtu përfshihen edhe depozitat në formën e garancive për huatë me maturitet më shumë se 3 muaj ose më pak nga data origjinale.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Aktiveve të tjera financiare afatshkurtra**

Aktive të tjera financiare afatshkurtra, kërkesa të arkëtueshme afatshkurtra, letra me vlerë dhe investime të tjera financiare janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale të lëshuara apo dokumentëve të tjerë kontabël. Politika kontabël e ndjekur për aktivet financiare afatshkurtra është sipas kostos së amortizuar (vlerë nominale të kërkesës për arkëtim minus zhvlerësim nëse ka) sipas SKK 3. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave dhe dokumentëve origjinalë kontabël. Llogaritë e aktiveve të tjera financiare afatshkurtra të monedhë të huaj, në datën e mbylljes së bilancit janë vlerësuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2019. Diferencat respektive janë të reflektuara në llogaritë e rezultatit.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Gjendjeve të Inventarit**


Gjendjet e Inventarit të shoqërisë përbëhen nga Mallrat për rishitje të cilat vlerësohen me vlerën më të vogël të kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përfshin materialin direkt dhe punën direkte kur është e aplikueshme dhe kostot e tjera që janë shpenzuar për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendin aktual. Vlera neto e realizuar tregon vlerën e çmuar të çmimit të shitjes në aktivitetin e biznesit, duke i zbritur koston e çmuar të marketingut, shitjes dhe shpenzimeve. Kostoja e inventareve të tjerë është bazuar në parimin FIFO (e hyra e parë e dalja e parë) dhe përfshin shpenzimet e përdorura në përvetësimin e inventarit dhe për të sjellë ato në kushtet dhe vendin e tyre ekzistues. Shuma e përshtatshme për zhvlerësim njihet në pasqyrën e të ardhurave kur ka një evidencë objektive që aktivi është zhvlerësuar. Kosto e inventarit është llogaritur për çdo zë duke përdorur metodën FIFO në zbatim të SKK 4. Në të përfshihen shpenzimet e blerjes së mallrave, shpenzimet e transportit, shpenzimet në doganë, shpenzimet e ngarkim-shkarkimit të çdo shpenzimi tjetër i bërë deri në magazinimin e mallrave.

✓ **Rregulla për vlerësimin e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra përfaqsojnë shpenzimet e bëra gjatë vitit financiar por që nuk përjasin periudhave të ardhshme të njësisë ekonomike. Për to është ndjekur politika kontabël kosto minus zhvlerësim nëse ka, pasqyruar sipas përcaktimit të zbatimit të SKK 1.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Aktiveve Afatgjata**

Aktivët afatgjatë material dhe jomaterial pasqyrohen në bilanc me vlerën e tyre neto



"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT LAUDITUESIT LIGJOR

Aktivet Afatgjatë jomaterialë sipas SKK 5 janë përfshirë në Pasqyrat Financiare duke ndjekur politikën kontabël Kosto e blerjes ose prodhimit ose shumën e rëvlerësuar minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin nëse ka.

Aktivet Afatgjatë materialë sipas SKK 5 janë përfshirë në Pasqyrat Financiare duke ndjekur politikën kontabël Kosto e blerjes ose prodhimit ose shumën e rëvlerësuar minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin nëse ka. Metoda e llogaritjes së amortizimit bëhet në zbatim të ligjit Nr.8438 datë 28.12.2008 "Për Tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar. Baza e llogaritjes së amortizimit bëhet mbi Vlerën Neto Kontabël. Llogaritja e amortizimit për aktivet e hyra gjatë vitit është bërë duke filluar nga data 1 e muajit pasardhës.

1. Njohja dhe matja


Zërat e aktiveve afatgjata materialë paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih me poshte) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, (nëse ka).
E gjithë pasuria e paluajtshme, ndërtesat dhe makineritë paraqiten në kosto, historike (shih pershkruhet në paragrafin e mëposhtëm) minus amortizimin përkatës dhe zhvlerësimin, përveç për tokën, e cila pasqyrohet me koston historike minus zhvlerësimin. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve, punës direkte, si dhe çdo kosto tjetër që lidhet me sjelljen e këtyre aktiveve në gjendje pune dhe kostot për çmontimin dhe lëvizjen e tyre dhe përgatitjen e vendit në të cilin do të vendosen. Programet kompjuterike të blera që janë të nevojshme për vendosjen në funksion të këtyre aktiveve të cilat kapitalizohen si pjesë të këtyre makinerive. Aktivët të cilat janë nxjerrë jashtë përdorimit kanë qenë të kontabilizuar me vlerën e bazuar në vlerën e tyre neto në datën e daljes jashtë përdorimit. Kostot e pjesëve të ndërtimit për makineritë dhe pajisjet njihen me vlerën e tyre kontabël nëse është e mundur që njësi ekonomike të përfitojë të ardhura ekonomike nga kjo pjesë dhe këto të ardhura mund të maten në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes dhe riparimeve të përditshme të pasurive të paluajtshme, makinerive dhe pajisjeve njihen në fuqinë e humbjeve kur ato ndodhin.

2. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare mbi vlerën e mbetur kontabël në mënyrë që, kosto e çdo aktivi deri në vlerën e mbetur, të shpërndahet përgjatë të gjithë jetës së tij të dobishme si me poshte:

Ndërtesat	5 %
Instalime teknike, makineri e pajisje	20%
Mjete transporti	20%
Mobilje dhe orëndi	20%
Pajisje zyre dhe informatike	25%

"AZ DISTRIBUTION" SHIPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESTIT LIGJOR



Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nëse nuk është e pakonsiderueshme) të aktiveve materiale afatgjatë janë rishikuar në datën e raportimit. Toka dhe Ndërtimet në Proçes, si dhe parapagimet furnitorëve nuk amortizohen. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen nga krahasimi i përfitimeve me vlerën e tyre kontabël. Këto përfshihen në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

3. *Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuhen atij elementi do të rrjedhin Shoqërisë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

4. *Aktivet e marra me qira*

Aktivet e marra me qira janë të klasifikuara si qira financiare kur termat e transferimit të risipave dhe pronësisë kalojnë te qiramarresi. Të gjitha qeratë e tjera janë të klasifikuara si qira operative. Asetet që janë regjistruar si qira financiare regjistrohen si asete të Shoqërisë me vlerën e drejtë në datën e fillimit të qerasë, ose me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qerasë nëse kjo vlerë fundit është më e vogël. Pagesat e qerasë regjistrohen si shpenzime financiare dhe zvogëlimi i detyrimit të qerasë që të arrijë një normë konstante të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimit.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Huamarrjeve Afatshkurtra**

Në huamarrjet afatshkurtra përfshihen huatë (deri në 12 muaj) për financime afatshkurtra si dhe pjesa e huave dhe detyrimeve të qerasë financiare që do të paguheshin Brenda 12 muajve të ardhshëm të klasifikuara sipas SKK 3 dhe SKK 7 duke ndjekur politikën kontabël të kostos së amortizuar. Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kostot e pakësuar për humbjet për zhylerësime.


✓ **Rregullat për vlerësimin e Huave dhe Parapagimeve**

Huatë dhe parapagimet janë vlerësuar sipas faturave të blerjes dhe dokumentëve të tyre origjinalë kontabël. Politika kontabël e ndjekur është në bazë të kostos së amortizuar në zbatim të SKK 3.

BENDIS HUSI

LS2222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019



"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

✓ **Rregullat për vlerësimin e Huamarrjeve Afatgjata**

Në huamarrjet afatgjata përfshihen huatë (mbi 12 muaj) për financime afatgjata si dhe pjesa e huave dhe detyrimeve të qerasë financiare që do të paguhet pas 12 muajve të ardhshëm të klasifikuara sipas SKK 3 dhe SKK 7 duke ndjekur politikën kontabël të kostos së amortizuar.

✓ **Rregullat për vlerësimin e Kapitalit**

Kapitali i shoqërisë vlerësohet sipas vlerës kontabël të kapitalit aksionar të emetuar në kapitullin e saj, rezervave të krijuara në përputhje me statutin si dhe në përputhje me ligjin "Për Shoqëritë Tregtare" ose ndonjë ligj tjetër të aplikueshëm. Fitimeve të pashpërndara që përbejnë fitimet e akumuluar në vite si dhe fitimi ose humbja e vitit financiar që përbehet nga fitimi ose humbja në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

✓ **Rregullat e vlerësimit të të Ardhurave**

Të ardhurat përfaqsojnë shitjet neto e rrjedhimisht të ardhurat e përfituara nga shitja e mallrave dhe produkteve, shërbimeve gjatë periudhës kontabël të vlerësuar sipas SKK 8. Ato regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe të lidhjes që kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, pavarësisht se arkëtimi i tyre ose i një pjese prej tyre do të ndodhë në vitin ushtrimor pasardhës. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose për tu arkëtuar dhe përfaqëson vlerën e arkëtueshme për të mirat dhe shërbimet e siguruar gjatë aktivitetit normal të shoqërisë, neto nga zbritjet dhe shitjet të lidhura me taksën. Shitjet e mallrave njihen kur mallrat janë dërguar dhe gjithashtu kanë kaluar dhe pronësinë e tyre. E ardhura nga shërbimet e kryera njihet në pasqyrën e të ardhurave në përpjestim me volumin e shërbimit të kryer në datën e bilancit. Vlerësimi i volumit të shërbimit bëhet duke in referuarurvejimeve të punës së kryer.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Shpenzimeve Direkte**


Shpenzimet e njësisë ekonomike të vitit financiar përfaqsojnë shpenzimet e blerjes së mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara për veprimtarinë parësore, koston e shërbimeve kryesore të vlerësuar me çmimin e blerjes e të vërtetuara me fatura origjinale e dokumente të tjerë kontabël, shpenzime që lidhen në mënyrë direkte me mallrat ose produktet e destinuar për shitje. Pagat, shpërblimet dhe kompensimet monetare, sigurimet shoqërore të paguara nga shoqëria të llogaritura mbi pagat që i përkasin periudhës kontabël pavarësisht nëse ato janë

paguar ose jo. Shpenzimet për amortizimin që vijnë nga rënia në vlerë e aktiveve afatgjata. Shpenzimet e tjera që janë shpenzimet e papërfshira në zërat e mësipërm por që lidhen me veprimtarinë kryesore të njësisë ekonomike.

BENDIS HUSI

15222001G

Nr regj 368 dt 08.01.2019



✓ **Rregullat e vlerësimit të Shpenzimeve të Qerasë**

Pagesat e bëra për qeratë operationale njihen në fitim ose humbje me mënyrën lineare gjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së marrë njihen si një pjesë integrale e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë periudhës së qirasë. Minimumi i pagesave të qerasë të bëra nën qeratë financiare janë shpërndarë midis shpenzimeve financiare dhe pakësimit të detyrimit të mbetur. Shpenzimi financiar është shpërndarë në çdo periudhë të termave të qerasë për të krijuar një normë interesi konstante periodike mbi tepricën e mbetur të detyrimit.

✓ **Rregullat e vlerësimit të shpenzimeve (të ardhurave) Financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuar në depozita bankare dhe fitimet nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave. Të ardhurat nga interesi njihen dhe përlogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Të gjitha kostot e huave njihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën e interesit efektiv.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Tatimit mbi Fitimin**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në keto raste tatim fitimi njihet si zë i kapitalit. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyjnë në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet në normën e tatimit që pritet të aplikohet në diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin tatimor që janë ose hyjnë në fuqi në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditimet tatimore të papërdorura. Aktiv i tatimor i shtyrë zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Fondit të Pensioneve**


Shoqëria paguan kontribute për pensione si dhe kontribute për sigurim shëndetsor për punonjësit e saj siç është parashikuar nga legjislacioni vendas. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtarë përgjegjës për pagesën e pensioneve dhe shërbimeve shëndetsore.

BENDIS HUSI

L5222001G

Nr rregj 368 dt 08.01.2019

"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR



Sigurime shoqërore të detyrueshme

Shoqëria, në rrjedhen normale të biznesit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin lokal. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

Leje vjetore të paguara

Shoqëria njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhen në këmbim për shërbimin e punonjësve për gjatë periudhës.

✓ **Rregullat e vlerësimit të Provizioneve**

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si një rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhjë e burimeve duke personifikuar fitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të rregulluar detyrimin dhe një vlerësim të besueshëm të vlerës së detyrimit që mund të bëhet. Nëse efekti është material, provizionet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë, dhe kur është e nevojshme riskun specifik të detyrimit. Provizionet paraqiten në çdo datë bilanci dhe nëse nuk është akoma e mundur që rrjedhja e burimeve duke personifikuar burime ekonomike të përdoret për rregullimet e detyrimeve, provizionet anulohen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje shfrytëzuese të ardhme. Aktivitetet dhe detyrimet e rastit nuk njihen.

✓ **Rregullat e Menaxhimit të Riskut Financiar**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumentave financiarë:


- Risku i kredisë
- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut

Menaxhimi mbart përgjegjësinë për vendosjen dhe mbikqyrjen e politikave të shoqërisë për menaxhimin e riskut. Këto politika duhet të rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e shoqërisë. Instrumentat financiarë kryesorë të shoqërisë:

BENDIS HUSI

L32222001G

Nr. regj. 368 dt. 08.01.2019



"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË
RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

konstatojnë në vlerat në arkë dhe në bankë, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme si dhe detyrime të tjera afatshkurtra.

Risku i kredisë

Në varësi të volumit të llogarive të arkëtueshme përcaktohet dhe risku i kredisë. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme mbahet në shumën e konsideruar të nevojshme për të mbuluar riskun potencial në mbledhjen e tepërave të llogarive të arkëtueshme.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj lidhur me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është i qëndrueshëm në shoqëri dhe menaxhohet duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet për flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Risku i tregut

Përbëhet nga risku i normave të interesit dhe risku i kursit të këmbimit.

Risku i normave të interesit

Shoqëria përballët me riskun e normës së interesit të flukseve të parasë në lidhje me llogaritë overdraft që ajo merr me normë variabël.

Risku i kursit të këmbimit

Llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme në monedhë të huaj apo huatë janë faktorë që e ekspozojnë shoqërinë ndaj riskut të kursit të këmbimit.


Analiza e ndjeshmërisë

Duke administruar riskun e normave të interesit dhe të pozicionit valuator, shoqëria mund të reduktojë ndikimet e llogaritë afatshkurtra në fitimet e saj. Në periudha afatgjata, suboptimizimi i këtyre risqeve mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në fitim.

BENDIS HUSI
L5222001G

Nr regj 368 dt 08.01.2010

Bendis Husi



"AZ DISTRIBUTION" SH.P.K TIRANË
RAPORT I AUDITUE SIT LIGJOR

Administrimi i Kapitalit

Politikat e shoqërisë janë të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit.

Zhylerësimi

(i) Aktivët financiarë

Një aktiv financiar konsiderohet i zhylerësuar nëse evidenca objektive zhylerësimi tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e parave të ardhshme të mjeteve monetare të aktivit financiar.

Humbja nga zhylerësimi i një aktivit financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësimit të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar.

Humbja nga zhylerësimi i një aktivit financiar të vlefshëm për shitje është llogaritur kundrejt vlerës së tij të drejtë. Aktivët financiarë të cilat janë të konsiderueshme individualisht testohen për zhylerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet së bashku në grupe që mbartin karakteristikë të ngjashme risku. Të gjitha humbjet nga zhylerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Ndonjë humbje kumulative në lidhje me aktivët financiarë të vlefshëm për shitje të njohura me parë në letra me vlerë transferohet tek humbje fitimi. Një humbje nga zhylerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhylerësim ka ndodhur për shkak të një ngritjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhylerësimi. Anullimi njihet në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Aktivët jo-financiarë

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shityra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhylerësim. Nëse ka evidencë të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbje nga zhylerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivit tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhylerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga zhylerësimi në periudhat e mëparshme janë rishikuar në çdo datë raportimi për rastet kur humbja rritet ose nuk ekziston më. Një humbje zhylerësimi anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për caktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhylerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhylerësimi.


Kontabiliteti mbrojtës dhe instrumentat derivativë financiarë

Shoqëria nuk përdor instrumenta financiare mbrojtëse, panvarësisht se është e ekspozuar ndaj riskut financiar.

PENDIS HUSI

L52222001G

Nr regj 368 dt 08.01.2019




❖ **ORGANIZIMI I KONTABILITETIT**

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me ligjin Nr.9477 datë 09.02.2006 dhe me SKK 2. Shoqëria ka ndërtuar një plan vetjak të llogarive në përputhje dhe në zbatim të SKK të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Departamenti i Financës përbëhet nga disa specialist financa. Kontabiliteti mbahet në mënyrë të informatizuar nëpërmjet programit të Kontabilitetit "Programi Alpha Platinum".

❖ **SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**

Qendër Hesi

HENDIS HUSI
1.52222001G
Nr regj 368 dt 08.01.2019



Emertimi Mikronjesise

NIPT -i

Adresa e Selise

Data e krijimit

Nr. i Regjistrimit Tregtar

Veprimtaria Kryesore

AZ Distribution shpk

L32204031E

Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, kulla Nr.1, Kati 13

Tirane

04/10/2013

Tregtimi karburantit te ndryshem me pakice,
si dhe vajrave lubrikante, te gazit te lengshem per ngrohje
pajisje ngrohese gazi, si dhe mbushjen e bombave te gazit
dhe tregtimi i tyre me pakice.

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit nr.2 dhe Ligjit Nr.9228, Date 29.04.2004
"Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare")

Viti 2019

Pasqyra Financiare jane te shprehura ne
Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne

Leke

Leke

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare

Nga

01.01.2019

Deri

31.12.2019

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare

30.03.2020




AKTIVET

		31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
I Aktive Afatshkurtra			
1 Mjetet Monetare		3,481,064	6,887,798
2 Investime			
1) Ne tituj proniesie te njesive ekonomike brenda grupit			
2) Aksionet e veta			
3) Te tjera financiare			
3 Te drejta te arketueshme	Totali	-	-
a) Nga aktiviteti i shfrytezimit			
b) Nga njesite ekonomike brenda grupit		660,516,533	433,209,914
c) Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese			
d) Te tjera			
e) Kapital i nenshkruar i papaguar		487,610	1,844,021
4 Inventari	Totali	661,004,143	435,053,935
a) Lende e pare dhe materiale te konsumueshme			
b) Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte		-	-
c) Produkte te gatshme			
d) Mallra			
e) Aktive biologjike (Gje e gjalle ne rritje e majmeri)		18,433,358	25,630,889
f) AAGJM te mbajtura per shitje			
g) Parapagime per inventar			
5 Shpenzime te shtyra	Totali	18,433,358	3,918,718
6 Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara		50,340,436	29,549,607
			117,400
Total i Aktiveve Afatshkurtra		733,259,001	471,608,740
II Aktive Afatgjata			
1 Aktive financiare			
a) Tituj proniesie ne njesite ekonomike brenda grupit			
b) Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grupit			
c) Tituj proniesie ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese			
d) Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese			
e) Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjata			
f) Tituj te tjere te huadhenies			
2 Aktive Afatgjata Materiale	Totali	-	281,130,960
a) Toka dhe ndertesa			281,130,960
b) Impiante dhe makineri		536,900,896	540,533,496
c) Te tjera instalime dhe pajisje		9,375,597	4,500,597
d) Mjete transporti		156,249,981	134,588,821
e) Parapagime per aktive materiale dhe ne proces		3,461,240	3,461,240
3 Aktive Biologjike Afatgjate	Totali	705,987,714	683,084,154
4 Aktive Afatgjata Jomateriale			
a) Koncesione, licensa, marka tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme		1,048,833	1,048,833
b) Emer i Mire			
c) Parapagime per AAJM			
5 Aktive tatimore teshtyra	Totali	1,048,833	1,048,833
Total i Aktiveve Afatgjata		707,036,547	965,263,947
TOTALI AKTIVEVE		1,440,295,548	1,436,872,687

Ekonomist:

Gisa Goni

[Handwritten signature]



PASIVET DHE KAPITALI

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
I Detyrimet afatshkurtra		
1 Huamarrjet		
1) Titujt e huamarrjes		
2) Detyrimet ndaj institucioneve te kredise		
3) Arketime ne avance per porosi		150,536,254
4) Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit		
5) Deftesa te pagueshme	343,395,715	216,094,865
6) Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit		
7) Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemarrese		
8) Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetesore	1,054,956	1,300,761
9) Te pagueshme per detyrimet tatimore	436,568	167,181
10) Te tjera	231,282	
Totali	345,118,521	368,099,061
4 Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
5 Te ardhura te shtyra		
6 Provizione		
Pasive Totale Afatshkurtra	345,118,521	368,099,061
II Detyrime afatgjata		
1 Huate afatgjata		
1) Titujt e huamarrjes		
2) Detyrime ndaj institucioneve te kredise		
3) Arketimet ne avance per porosi		
4) Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	706,906,676	680,724,774
5) Deftesa te pagueshme		
6) Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit		
7) Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemarrese		
8) Te tjera te pagueshme		
Totali	706,906,676	680,724,774
2 Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
3 Te ardhura te shtyra		
4 Provizione:		
1) Provizione per pensionet		
2) Provizione te tjera		
4 Detyrime tatimore te shtyra		
Pasive Totale Afatgjata	706,906,676	680,724,774
Totali i pasiveve	1,052,025,197	1,048,823,835
III Kapitali		
1) Kapitali i nenshkruar		
2) Primi i lidhur me kapitalin	466,194,300	466,194,300
3) Rezerva rivleresimi		
4) Rezerva te tjera		
a) Rezerva ligjore		
b) Rezerva statutore		
c) Rezerva te tjera		
5) Fitimi i pashperndare	(78,145,448)	(74,790,059)
6) Fitimi (humbje) e vitit financiar	221,499	(3,355,389)
Totali i Kapitalit	388,270,351	388,048,852
TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT	1,440,295,548	1,436,872,687


ADMINISTRATORI
Fatjon Mita

Ekonomisti:

Asa G, 04.

0
0

0



PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE


	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1 Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	698,562,072	675,684,082
2 Ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit ne proces		
3 Puna e kryer nga njesia ekonomike dhe e kapitalizuar		
4 Te ardhura te tjera te shfrytezimit	18,112,880	1,772,217
5 Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		
a) Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	(609,716,755)	(586,685,824)
b) Te tjera shpenzime		
6 Shpenzimet e personelit	(34,402,325)	(32,185,794)
a) Pagat dhe shperblimet	(29,595,539)	(27,713,258)
b) Shpenzimet e sigurimeve shoqerore/shendetesore	(4,806,786)	(4,472,536)
7 Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		
8 Shpenzime konsumi dhe amortizimi	(272)	(707)
9 Shpenzime te tjera shfrytezimi	(59,765,496)	(69,096,086)
	12,790,104	(10,512,112)
10 Te ardhura te tjera	18,224,383	-
Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa		
a) pjesemarrrese(paraqitur vecmas te ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit		
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera pjese e aktiveve		
b) afatgjata(paraqitur vecmas te ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)		
c) Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme(paraqitur vecmas te ardhurat nga njesite ekonomike brenda grupit)	18,224,383	
11 Zhvleresimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra		
12 Shpenzime financiare	(30,705,129)	7,214,423
a) Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme(paraqitur vecmas shpenzimet per t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)		
b) Shpenzime te tjera financiare	(30,705,129)	7,214,423
13 Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesemarrjet		
14 Fitimi/Humbja para tatimit	309,358	(3,297,689)
15 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	(87,859)	(57,700)
a) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	(87,859)	(57,700)
b) Shpenzimi aktual i tatimit fitimit te shtyre		
c) Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve		
16 Fitim (humbje) neto e vitit		
17 Fitim (humbje) per:	221,499	(3,355,389)
a) Pronaret e njesise ekonomike meme		
b) Interesa jo-kontrolluese		

ADMINISTRATORI

Fatjon Mita

Ekonomist:

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
(metoda indirekte)



Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	2019	2018
Fitim / Humbja e vitit	221,499	(3,355,389)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		
Zhvierësimi i aktiveve afatgjata materiale	(272)	(707)
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(276,173,244)	488,767,629
Rënie/(ritje) në inventarë	11,116,249	(8,853,309)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	127,801,519	(78,465,465)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(245,805)	(525,294)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(137,280,054)	397,567,465
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve		
Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(22,903,560)	(435,525,490)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		
Dividentë të arkëtuara		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(22,903,288)	(435,525,490)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	156,776,608	36,708,958
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		
Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		
Hua të arkëtuara		
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë		680,724,774
Riblerje e aksioneve të veta		
Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		
Pagesa e huave	156,776,608	(644,015,816)
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		
Interes i paguar		
Dividendë të paguar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	156,776,608	36,708,958
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(3,406,734)	(1,248,360)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	6,887,798	8,136,158
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	3,481,064	6,887,798

DIFERENCA

(0)

0


ADMINISTRATORI
Fatjon Mita

Ekonomist

Glaser Gjon

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2018	100,000	466,094,300	-	-	-	-	(75,114,905)	324,846	391,404,203	-	391,404,203
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Fitimi / Humbja e											
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:								(3,355,389)	(3,355,389)		(3,355,389)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									-		-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar									-		-
Dividendë të paguar									-		-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									-		-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100,000	466,094,300	-	-	-	-	(75,114,905)	(3,030,543)	388,048,814	-	388,048,814
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2019	100,000	466,094,300	-	-	-	-	(75,114,905)	(3,030,543)	388,048,852	-	388,048,852
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Fitimi / Humbja e											
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:								221,499	221,499		221,499
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									-		-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të									-		-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar									-		-
Dividendë të paguar									-		-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									-		-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	100,000	466,094,300	-	-	-	-	(75,114,905)	(2,809,044)	388,270,351	-	388,270,351

ADMINISTRATORI
Fatjon Mita

0

Ekonomisti:

PKZOR


Gisa Gjoni

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE, SHOQËRISË
"AZ DISTRIBUTION" SHPK TIRANË**

Për ushtrimin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2019

TË PËRGJITHSHME DHE POLITIKAT KONTABEL

Shoqëria "AZ DISTRIBUTION" shpk, u regjistrua si biznes në datë 04/10/2013 me administrator Z. Fatjon Mita, me objekt veprimtarie: Tregtimi me pakice të benzines, naftes, gazit, lubrifikanteve etj. Kjo shoqëri është regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT L32204031E.



MBI POLITIKAT KRYESORE TË KONTABILITETIT

Pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2019 janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe të ligjit 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin e pasqyrat financiare"

Kontabiliteti i shoqërisë "AZ DISTRIBUTION" shpk, është i organizuar rregullisht, i mbështetur mbi sistemin manual të mbajtjes të kontabilitetit, si dhe ata të informatizuar të cilat mundësojnë jo vetëm regjistrimin e të dhënave por dhe marrjen e informacionit, respekton të gjitha kërkesat e Planit Kontabël, ligjin mbi Kontabilitetin dhe kërkesat e tjera ligjore. Llogaritë e ushtrimit financiar të vitit 2019 janë hartuar me hipotezën e vijueshmërisë dhe janë zbatuar vlerësimet e parashikuara në këtë situatë.

Monedha në të cilën shprehen të gjitha pasqyrat financiare është leku shqiptar pa bërë rrumbullakime.

VLERËSIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Efikasiteti i kontrollit të brendshëm është i lidhur me sigurimin e mbrojtjes së pasurisë nga cdo lloj dëmtimi e shpërdorimi dhe në të njëjtën kohë të sigurojë besnikërinë e informacionit administrativ, kontabël e financiar duke qenë i besueshëm nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga përdoruesit.


Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga ndarja e punës, verifikimet dhe deri tek informimet, veprime këto që përgjithësisht në Entitet janë realizuar.

SHËNIME MBI ZËRAT E LLOGARIVE NË PASQYRAT FINANCIARE

**AKTIVI
AKTIVET MONETARE**

Në këtë pozicion të bilancit janë pasqyruar, aktivet monetare në vlerën **3,481,064 lekë**, përcaktuar në llogaritë në arkë dhe në bankë. Ka vijueshmëri në regjistrimin e dokumentave, përse i takon datave dhe ka dokumenta justifikuese për veprimet e kryera. Diferenca e likuiditeteve për vlerën 3,406,734 lekë, e pasqyruar drejt në pasqyrën e fluksit monetar bashkangjitur bilancit, përputhet me pasqyrimin e tyre në aktiv të bilancit.

Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2018	6,887,798 lekë
Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2019	3,481,064 lekë
Diferenca	3,406,734 lekë



AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFATSHKURTËRA

Të drejta të arkëtueshme të tjera në vlerën 661,004,143 lekë ku përfshihen llogaria 411 "Klientë për mallra, produkte e shërbime", 4453 "TVSH për tu marrë".

INVENTARI

Inventari për vlerën 18,433,358 leke ku përfshihet llogaria 35 "Mallra".

SHPENZIME TE SHTYRA

Shpenzimet e shtyra për vlerën 50,340,436 lekë ku përfshihet llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhme" dhe llogaria 47 "Llogari të përkohshme ose në pritje".

AKTIVE AFATGJATA

Aktive afatgjata materiale në vlerën 705,987,714 leke ku përfshihen llogaritë, llogaria 211 "Toka", llogaria 212 "Ndertesa dhe rikonstrukcion pika karburanti", llogaria 213 "Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente", llogaria 215 "Mjete transporti", llogaria 2181 "Mobilje dhe pajisje zyre" llogaria 2182 "Pajisje informative", llogaria 2186 "Reklama, Tenda", llogaria 2818 "Perte tjera AA materiale" etj.

Aktive afatgjata jomateriale në vlerën 1,048,833 leke ku përfshihen llogaritë, llogaria 205 "Koncesione dhe të drejta të ngjashme, licenca të ngjashme" dhe llogaria 208 "Të tjera AA jomateriale".

PASIVI

HUATË E PARAPAGIMEVE

Për vitin ushtrimor 2019 detyrimet në total janë në vlerën 1,052,025,197 lekë që në mënyrë analitike janë si më poshtë:

Detyrimet afatshkurtra me vlerë totale 345,118,521 lekë, ku përfshihen:

Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit në vlerën 343,395,715 leke, ku përfshihet llogaria 401 "Furnitorë për mallra, produkte e shërbime".

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 1,054,956 lekë, ku përfshihet: llogaria 421 "Paga dhe shpërblime" 463,226 lekë dhe llogaria 431 "Sigurime shoqërore dhe shëndetësore" 591,730 lekë.

Të pagueshme për detyrimet tatimore në vlerën 436,568 lekë, ku përfshihet llogaria 442 "Tatimin mbi të ardhurat personale" në vlerën 111,555 lekë dhe llogaria 449 "Tatim në burim" 306,860 leke, llogaria 444 "Tatim mbi fitimin" në vlerën 18,153 lekë.

Të pagueshme të tjera në vlerën 231,282 lekë ku përfshihet llogaria 418 "Parapagime të dhëna".

Detyrime afatgjata në vlerën 706,906,676 ku përfshihen detyrime ndaj institucioneve kreditore.

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



KAPITALI

Gjendja e llogarive të Kapitalit dhe Rezervave të Shoqërisë në përfundim të periudhës është në vlerën **388,270,350** dhe përbëhet nga Kapitali i nënshkruar për 466,194,300 lekë, humbja e pashpërndarë në vlerën 78,145,448 dhe Fitimi i vitit ushtrimor 2019, marrë nga PASH, me vlerë 221,499 lekë.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin 2019 Shoqëria "AZ DISTRIBUTION" shpk ka realizuar shpenzime në masën **734,589,977** lekë nga veprimtaria e shfrytëzimit. Shpenzimet janë si më poshtë:

Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme 610,440,240 lekë ku përfshihen: llogaria 605 "Blerje/shpenzime të materialeve".

Shpenzimet e personelit : 34,402,325 lekë ku përfshihen llogaria 641 "Pagat dhe shpërblimet e personelit" në vlerën 29,595,539 lekë dhe llog 644 "Sigurimet shoqërore dhe shendetesore" në vlerën **4,806,786 leke**.

Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit 59,046,986 lekë ku përfshihen: llogaria 613 "Qira, llogaria 616 "Sigurime njesi shitje", llogaria 618 "Të tjera" ku përfshihen llogaritë e shërbimeve noteriale, shpenzimet e konsulencës, etj, llogaria 615 "Mirëmbajtje Stacione Karburanti", llogaria 634 "Taksa dhe tarifa vendore", llogaria 638 "Tatime të tjera", llogaria 657 "Gjoha dhe demshperblime", etj.

Shpenzimet financiare në vlerën 30,700,426 leke përfshijnë:
Llogaria 628 "Shërbime bankare" dhe llogaria 667 "Shpenzime për interesa",


Shpenzimet e tatimit fitimit, llogaria 69, për shumën 87,859 lekë.

MBI TË ARDHURAT

Shoqëria ka realizuar të ardhura në masën **734,899,334 lekë** nga veprimtaria e shfrytëzimit ku përfshihet: Llogaria 705 "Shitje mallrash" në vlerën 698,562,072 lekë dhe llogaria 708 "Të ardhura nga shtije të tjera, lavazh" në vlerën 18,112,880 llogaria 767 "Të ardhura nga interesi" në vlerën 18,224,383.

PËRLLOGARITJA E TATIM FITIMIT

FITIM/(HUMBJA) E USHTRIMIT	309,358
SHPENZIME TE PANJOHURA	276,367
HUMBJE TE MBARTURA	0
TATIM FITIMI (15%).	87,859
FITIM/(HUMBJA) TATIMORE	585,725



PASQYRA E FLUKSIT TË PARAVE-Metoda Indirekte

Eshtë ndërtuar nga ana e jonë në përputhje me standartet kombëtare të kontabilitetit, bazuar në levizjet e mjeteve monetare të shoqërisë sipas kërkesave që ka vetë pasqyra dhe në perfundim rezulton:

Mjete monetare në fillim **6,887,798** lekë

Mjete monetare në fund të periudhës **53,704,099** lekë

Rritja/rrenja neto e mjeteve monetare **46,816,301** lekë

Pra, ka përputhje të plote të pasqyres të fluksit monetar dhe gjendjes të aktiveve monetare të vendosura në aktiv të bilancit.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Eshtë plotësuar sipas kërkesave duke patur parasysh të gjitha ndryshimet e kryera midis dy periudhave ushtrimore dhe ku gjëndja e këtyre kapitaleve të vet shoqërisë në fund të periudhës paraqitet me një vlerë prej **388,270,351** lekë e cila paraqitet si në pasqyrën e ndryshimit të kapitaleve, po ashtu edhe në postin e kapitaleve në pasiv të bilancit 2019.


SHËNIME TË TJERA SHPJEGUESE

Ngjarje të tjera të ndodhura pas datës të bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës të bilancit që nuk bëhen rregullime, nuk ka.

Duke patur parasysh shënimet e mësipërme, paraqitim të gjitha aspektet, të gjendjes financiare të shoqërisë deri më 31.12.2019.

Tiranë , më 30.03.2020

Ekonomisti




Administratori
Fatjon Mita

